# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5733
E shtunë, 23 mars 2019
çmimi 0.40 €


## I jepet lamtumira e fundit nënës së heroit Edmond Hoxha FAQE 10




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", MEMLI KRASNIQI FAQE 4-5

# Opozita nuk e rrezikon koalicionin qeverisës



Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se është e pasinqertë kërkesa e opozitës për zgjedhje të reja. Ai ka thënë se kjo ka të bëjë më shumë me marketing politik meqenëse, sipas Krasniqit, asnjëra prej partive opozitare nuk dëshiron zgjedhje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se opozita nuk e ka rrezikuar dhe nuk e rrezikon koalicionin qeverisës. Madje, sipas Krasniqit, sa i përket kësaj opozite, koalicioni mund ta çojë mandatin deri në fund. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi, ka folur edhe për dialog, me ç'rast ka thënë se Kosova duhet ta luajë rolin e vet si partnere e besueshme e ShBA-së dhe BE-së në këtë proces. Kurse sa i përket taksës, ai ka theksuar se, nëse do t'i rrezikonte raportet Kosovë - Amerikë, secili politikan do ta trajtonte seriozisht këtë çështje

## AKTUALE

### LËVIZJET NACIONALÇLIRIMTARE DHE PËRDORIMI I GABUESHËM I FJALËS 'ILEGAL' F. 11

Bardhyl MAHMUTI



### POLICIA ARRESTON TRE PJESËTARË TË NJË GRUPI KRIMINAL, KONFISKON 99 ARMË ZJARRI F. 7

### SHTATËVJEÇARI NGA KOSOVA VRITET ME THIKË NË ZVICËR NGA NJË 75-VJEÇARE F. 2



## KUVENDI MIRATON REZOLUTËN PËR PEZULLIMIN E LOJËRAVE TË FATIT



Me 74 vota për dhe asnjë kundër, Kuvendi i Kosovës ka miratuar të premten rezolutën e propozuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK-ja), ku kërkohet pezullimi i aktiviteteve të kazinove dhe lojërave të fatit si dhe plotësimndryshimi i ligjit përkatës. Nëpërmjet rezolutës obligohet qeveria t'i nisë procedurat ligjore për pezullimin e lojërave të fatit deri në ndryshim të ligjit, ndërsa brenda 30 ditëve ta sjellë ligjin që ndalon lojërat e fatit FAQE 9

## Kuvendi, vitin e kaluar, më produktivi për përmbushjen e agjendës legjislative FAQE 7



## EKONOMI

### MINISTRI SHALA E VENDOS KOSOVËN NË FOKUS TË INVESTITORËVE FRANCEZË F. 8

### KOSOVA KA PËRMBUSHUR TË GJITHA KËRKESAT E MARRËVESHJES SË BRUKSELIT PËR ENERGJI F. 8

## KULTURË

### KËTO DITË NË SHKUP U PËRURUA LIBRI 'FITORJA DIPLOMATIKE' I SABRI KIÇMARIT F. 6

## SPORT

### SERMAXHAJ: SUKSESI NË LIGËN E KOMBEVE, JO I RASTËSISHËM F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617 MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Blerim Reka do të garojë me numrin 1 në zgjedhjet presidenciale

SHKUP, 22 MARS - Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) i Republikës së Maqedonisë së Veriut të premten ka tërhequr shortin për numrin rendor të kandidatëve në fletën e votimin në zgjedhjet presidenciale.
Më 21 prill, në fletën e votimit kandidatët do të renditen si më poshtë:
Me numrin rendor 1 do të jetë kandidati i pavarur, shqiptari i vetëm në këtë garë, Blerim Reka; me numrin 2 do të garojë kandidatja e VMRO-DPMNE-së, Gordana Siljanovska; dhe me numrin 3 do të garojë kandidati i 30 partive politike, Stevo Pendarovski.
Kryetari i KSHZ-së, Oliver Derkoski, ka apeluar që kandidatët t'u shmangen paraqitjeve publike dhe deklaratave deri më 1 prill, kur edhe zyrtarisht do të fillojë fushata zgjedhore, për të përfunduar më 19 prill.
Pas kësaj do të pasojë heshtje zgjedhore prej 48 orësh.
Rrethi i parë zgjedhor për zgjedhjet e gjashta presidenciale do të jetë më 21 prill, ndërsa i dyti më 5 maj.
Rrethi i dytë i zgjedhjeve do zhvillohet nëse asnjë kandidat për president nuk e fiton shumicën e nevojshme të votave.
Shefat e shtabeve zgjedhore kanë premtuar fushatë zgjedhore të qetë, evropiane dhe demokratike.
Bashkë me zgjedhjet presidenciale, do të mbahen edhe zgjedhjet lokale në tri komuna: Dibër, Ohër dhe Novoselë.



# Shtatëvjeçari nga Kosova vritet me thikë në Zvicër nga një 75-vjeçare

Të enjten rreth orës 12:00 një djalë shtatëvjeçar, me prejardhje nga Kosova e me banim në Bazel të Zvicrës, ka ndërruar jetë pasi që ishte therur me thikë për vdekje nga një zvicerane 75-vjeçare. E dyshuara për kryerjen e këtij krimi tragjik është arrestuar nga autoritetet zvicerane



BERNË, 22 MARS (ER) - Një shtatëvjeçar me prejardhje nga Kosova është mbytur të enjten me thikë nga një 75-vjeçare në Bazel të Zvicrës. E dyshuara për kryerjen e këtij krimi tragjik është arrestuar nga autoritetet zvicerane, ndërsa motivet për kryerjen e këtij krimi mbeten të paqarta.
Ambasada e Republikës së Kosovës në Zvicër ka marrë lajmin e hidhur dhe shumë të rëndë për vrasjen mizore të fëmijës së Ilaz Mahmutit, i lindur më 3. 12. 2011, nga Komuna e Lipjanit. "Ai u vra dje me armë të ftohtë në rrugë, pak pas orës 12:00 të ditës, kur kishte përfunduar mësimin e paradites në shkollë dhe ai shkonte në banesën e vet. Ambasadorja Nazane Breca, në emër të saj, në emër të Ambasadës dhe gjithë stafit diplomatik, konsullor dhe stafit teknik, familjes Mahmuti nga Lipjani, me banim dhe punë në qytetin e Bazelit, i shpreh ngushëllimet më të thella për këtë tragjedi familjare. Kjo vrasje e ka tronditur komunitetin e madh shqiptar në Zvicër, ka tronditur gjithë Kosovën, banorët e Bazelit dhe gjithë qytetarët zviceranë", është thënë në reagimin e Ambasadës së Kosovës në Zvicër.
Ambasada e Republikës së Kosovës në Zvicër ka autorizuar një diplomat të saj që të kontaktojë dhe të jetë afër familjes, në mënyrë që t'ua ofrojë ndihmën e duhur e të nevojshme në këto çaste të rënda, si dhe të merren informacionet zyrtare nga organet përgjegjëse të Kantonit të Bazelit për këtë rast të rëndë tragjik.
Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë se vrasja makabre e shtatëvjeçarit në Bazel ka tronditur gjithë opinionin në Kosovë dhe Zvicër. "Në këto momente shumë të rënda ndaj dhimbjen me familjen e Mërgimit. E gjitha Kosova dhe Zvicra do të lutet për të", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".
Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli ka thënë se bashkëndien me dhimbjen e familjes dhe të afërmve të Mërgimit, fëmijës shtatëvjeçar nga Kosova, që mizorisht u vra në Zvicër. Po ashtu, edhe kryeministri Ramush Haradinaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se ndan dhembjen e madhe dhe ia përcjellë ngushëllimet më të thella familjes së Mërgimit, të vrarë në Bazel të Zvicrës. "Mendimet dhe lutjet e mia janë me ju në këto çaste të rënda", ka shkruar kryeministri Haradinaj.

## Bardosh: Pak gjasa për një marrëveshje Kosovë-Serbi më 2019

UASHINGTON, 22 MARS - Ndihmës drejtori në Institutin Hariman të Universitetit Kolumbia, Gordon Bardosh, tha se nuk është optimist që këtë vit mund të arrihet një marrëveshje mes Kosovës dhe Serbisë.
Eksperti për Evropën Juglindore, i tha Radios Evropa e Lirë, se në Prishtinë dhe Beograd mungojnë kapacitetet politike për të arritur një marrëveshje.
"Pikëpamja ime për situatën është kjo: në Prishtinë dhe Beograd nuk ka kapacitete politike që tash të arrijnë një marrëveshje. Gjithashtu, nuk është e qartë se ka mbështetje në Bruksel dhe Uashington për këtë. Kam përshtypjen se në këtë moment nuk duket se do të ndodhë diçka e rëndësishme", deklaroi Bardosh.
Eksperti amerikan tërheq paralele mes bisedimeve Kosovë-Serbi dhe procesit të komplikuar që kishte ndodhur në bisedimet për arritjen e marrëveshjes së Dejtonit për paqen në Bosnjë e Hercegovinë.
"Nëse kujtojmë luftën në Bosnjë e Hercegovinë dhe gjithë atë që bëri Qeveria amerikane kur Richard Holbrooke (1941 -2010) i dërgoi liderët e Serbisë, Bosnjës dhe Kroacisë në Dejton dhe i la aty për tri javë derisa u dakorduan për një marrëveshje. Kur e shohim këtë nivel të angazhimit, mendoj se jemi larg një marrëveshje për Kosovën", tha Bardosh.
Bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë ndërprerë për shkak të vendosjes së tarifës ndaj mallrave serbe nga ana e Qeverisë së Kosovës mirëpo nga Brukseli dhe Uashingtoni po bëjnë thirrje që palët të ndalin veprimet që dëmtojnë procesin negociator dhe të kthehen në tryezën e bisedimeve.




Presidenti i SBA-së, Donald Trump, kohë më parë përmes letrave dërguar presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe atij të Serbisë, Aleksandar Vuçiq ka thënë se dyja vendet duhet ta shfrytëzojnë këtë moment unik për të arritur një marrëveshje paqeje. Presidenti Trump ftoi dy presidentët për ta festuar atë në Shtëpinë e Bardhë.

EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka prezantuar raportin e monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2018

# Kuvendi, vitin e kaluar, më produktivi për përmbushjen e agjendës legjislative




**Vitin e kaluar Kuvendi i Kosovës kishte përmirësuar parametrat e përmbushjes së agjendës legjislative. Sipas raportit të Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) për monitorimin e punës së Kuvendit, ky institucion për herë të parë në shumë vite është parë si më produktiv për përmbushjen e agjendës legjislative, nga 36 për qind sa ishte në vitin 2015/2016, në 42 për qind në 2018-n. Megjithatë, ky raport ka evidentuar se mungesa e kuorumit dhe mbikëqyrja shumë e ulët e zbatimit të ligjeve kanë qenë mangësitë kryesore gjatë vitit të kaluar**

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 22 MARS - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka vlerësuar të premten se vitin e kaluar Kuvendi i Kosovës ka përmirësuar parametrat e përmbushjes së agjendës legjislative. Megjithatë, në raportin e monitorimit të punës së Kuvendit për vitin 2018 të këtij instituti, është konstatuar se mungesa e kuorumit, mbikëqyrja shumë e ulët e zbatimit të ligjeve, regresi në transparencën financiare, numri i ulët i dëgjimeve publike dhe organizimi jo i mirëfilltë i punës kanë qenë disa prej mangësive evidente që e kanë përcjellë punën e këtij institucioni gjatë vitit të kaluar.

Agnesa Haxhiu nga KDI-ja ka bërë me dije se 42 seanca të Kuvendit dhe 437 mbledhje të komisioneve parlamentare i kanë mundësuar organit më të lartë ligjvënës, që për herë të parë në shumë vite të shihet si më produktiv për përmbushjen e agjendës legjislative, nga 36 për qind sa ishte në vitin 2015/2016, në 42 për qind në 2018. Sipas saj, 75 ligjet e miratuara dhe 16 nisma ligjore nga vetë Kuvendi nuk kanë mundur t'i kamuflojnë problemet bazike me të cilat është përballur ky institucion. "Mungesa e kuorumit ka qenë pengesë serioze për marrjen e vendimeve në seanca. Kështu, shumë pika të papërfunduara të rendit të ditës nga seanca të ndryshme janë grumbulluar dhe vendosur në agjendën e një seance të vetme, fenomen ky që është përsëritur vazhdimisht përgjatë vitit", ka shpjeguar Haxhiu teksa ka prezantuar raportin.

Haxhiu ka theksuar se miratimi i ligjeve është përcjellë shpeshherë me shkelje të Rregullores së Punës së Kuvendit. "Edhe pse Rregullorja përcakton se amendamentet votohen si të veçanta, në raste të shpeshta ato janë votuar në grup, siç është rasti me Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Po ashtu, Kuvendi edhe këtë vit ka vazhduar praktikën e shqyrtimit të projektligjeve në procedurë të përshpejtuar", është shprehur ajo.

Deputetët pjesëmarrës në këtë diskutim kanë theksuar domosdoshmërinë që gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti të adresohen nga Kuvendi, e posaçërisht çështja e mbarëvajtjes dhe organizimit të mirëfilltë të punës dhe ngritjes së transparencës financiare. Deputeti i PDK-së, Elmi Reçica, ka deklaruar se në shikim të parë kjo legjislaturë duket më e dobëta, por në raportin e statistikave dhe punës dëshmohet se kjo legjislaturë ka qenë e suksesshme. "Nëse marrim për bazë çfarë shkruhet, çfarë thuhet dhe çfarë është perceptimi për këtë legjislaturë, vërtet do të duhej të dukej se është legjislaturë më e dobët dhe më pak kompetente. Por, nëse e shohim raportin, nuk del ashtu sepse, megjithatë, çdo gjë përfundon në numër dhe në angazhime konkrete. Nga hulumtimet dhe diskutimi i sotëm për këtë raport do të dëshmohet se kjo legjislaturë që ka qenë mjaft e suksesshme", ka deklaruar Reçica.

Kurse deputeti i LDK-së, Armend Zemaj, ka deklaruar se LDK-ja është angazhuar që ta ushtrojë mandatin e saj përfaqësues, ligjvënës dhe mbikëqyrës. "Ne kemi qasje të ndryshme në raportin tonë pozitë-opozitë", ka thënë Zemaj.

E deputetja e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka shpjeguar mungesën e opozitës në Kuvend gjatë vitit të kaluar. Sipas saj, kjo mungesë e opozitës në seanca lidhet me idenë e presidentit për korrigjim të kufirit. "Aktualisht janë duke pritur edhe 63 pika për shqyrtim dhe nuk mund të ketë organizim të punës së Kuvendit kur kryetari i këtij institucioni nuk e ka prioritet punën e Kuvendit. Ai i ka prioritet çështjet e tjera, por jo Kuvendin e Republikës së Kosovës. Rregullorja parasheh që të paktën dy herë në muaj të kemi seanca parlamentare. Natyrisht se janë mbajtur edhe më shumë për shkak edhe të seancave të jashtëzakonshme, mirëpo me sa më kujtohet mua, kur ka qenë Jakup Krasniqi kryetar i Kuvendit, janë mbajtur seancat të enjten, kanë vazhduar të premten, ndërsa tash mbahen të hënën, të premten dhe të mërkurën. Andaj kjo i prish komplet mbledhjet e komisioneve parlamentare", ka deklaruar Haxhiu.

Kjo tryezë është realizuar në kuadër të projektit "Rritja e pjesëmarrjes, transparencës dhe llogaridhënies në Kosovë", i financuar nga Fondi për Demokraci i Kombeve të Bashkuara (UNDEF).

## MPJ-ja shënon 20-vjetorin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë

PRISHTINË, 22 MARS (ER) - Me rastin e shënimit të 20-vjetorit të ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, në ambientet e Ministrisë së Punëve të Jashtme të premten është organizuar një pritje për të shprehur mirënjohje për mbështetjen dhe partneritetin e vazhdueshëm ndaj shteteve aleate, partnere dhe mike.

Me këtë rast, zëvendësministrja e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, Rejhan Vuniqi, ka thënë se ndërhyrja e NATO-s ndezi shpresën për shpëtim, liri dhe paqe. Vuniqi ka thënë se ishte vullneti i popullit të Kosovës për liri që u sublimua në vullnetin e përbashkët për veprim, për reagim ushtarak, pas dështimeve të diplomacisë dhe që në fund e bëri të pashmangshme ndërhyrjen humanitare të NATO-s.

Në këtë ceremoni ka marrë pjesë edhe ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës, Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ambasadorë dhe përfaqësues nga kori diplomatik i akredituar në Kosovë, atashe ushtarakë, përfaqësues nga KFOR-i dhe zyrtarë të tjerë.



Flet për "Epokën e re", Memli Krasniqi

# Opozita nuk e rrezikon



Nënkryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka thënë se është e pasinqertë kërkesa e opozitës për zgjedhje të reja. Ai ka thënë se kjo ka të bëjë më shumë me marketing politik meqenëse, sipas Krasniqit, asnjëra prej partive opozitare nuk dëshiron zgjedhje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se opozita nuk e ka rrezikuar dhe nuk e rrezikon koalicionin qeverisës. Madje, sipas Krasniqit, sa i përket kësaj opozite, koalicioni mund ta çojë mandatin deri në fund. Shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi, ka folur edhe për dialog, me ç'rast ka thënë se Kosova duhet ta luajë rolin e vet si partnere e besueshme e ShBA-së dhe BE-së në këtë proces. Kurse sa i përket taksës, ai ka theksuar se, nëse do t'i rrezikonte raportet Kosovë - Amerikë, secili politikan do ta trajtonte seriozisht këtë çështje

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 22 MARS - **"Epoka e re":** *Z. Krasniqi, pas disa seancave të ndërprera, në mungesë të kuorumit, të premten Kuvendi ka arritur që ta miratojë rezolutën për ndalimin e lojërave të fatit. Do të thotë kjo se Kuvendi iu ka kthyer funksionimit?*

**Krasniqi:** Nuk pajtohem me konstatimin që Kuvendi nuk ka qenë funksional. Një pjesë e opozitës e ka bojkotuar punën e Kuvendit por, pavarësisht prej kësaj, Kuvendi ka miratuar ligje, ka marrë vendime, ka votuar përzgjedhje konform autorizimeve që ka. Normalisht, nuk mund të them se nuk ka pasur vështirësi meqenëse, në raste të caktuara, nuk kemi arritur t'i përfundojmë seancat shkaku i mungesës së kuorumit. Por, sidoqoftë, seancën e së premtes e shoh si një hap pozitiv, veçanërisht kur kihet parasysh se ka pasur konsensus dhe pajtim të plotë në mes të të gjitha grupeve parlamentare sa i përket miratimit të rezolutës që kërkon nga qeveria fillimin e procedurave të pezullimit të aktiviteteve të lojërave të fatit në Kosovë.

**"Epoka e re":** *Si e komentoni funksionimin e koalicionit qeverisës dhe si PDK sa jeni të kënaqur me këtë bashkëqeverisje?*

**Krasniqi:** Ajo që qëndron si ylli polar i këtij koalicioni është programi qeverisës. E thashë figurativisht, por e vërteta është se kontrata jonë si parti politike në emër të këtij koalicioni është vetë programi i qeverisë. Për aq kohë sa programi qeverisës zbatohet, respektohet dhe mbetet baza e funksionimit të koalicionit, nuk shoh probleme në funksionim. Në anën tjetër, është krejtësisht e kuptueshme që parti të ndryshme politike edhe brenda koalicionit për çështje të caktuara të kenë mendime të ndryshme, sepse vetë fakti se jemi parti e ndryshme e shpjegon këtë gjë. Mirëpo në qeveri jemi për ta zbatuar programin të cilin e kemi miratuar bashkë. Deri tash nuk ka shmangie nga ky proces dhe për aq kohë sa ministrat janë duke i realizuar detyrat e veta konform kësaj marrëveshje dhe kryeministri duke udhëhequr qeverinë bazuar në këtë marrëveshje, atëherë nuk shoh probleme.

**"Epoka e re":** *Një prej sfidave kryesore me të cilat është ballafaquar kohët e fundit koalicioni qeverisës ka qenë çështja e taksës ndaj Serbisë, përkatësisht presioni ndërkombëtar për pezullimin e saj. A keni arritur ta gjeni formulën për tejkalimin e kësaj situate?*

**Krasniqi:** Për çështjen e tarifës doganore ndaj Serbisë dhe Bosnje Hercegovinës është folur shumë. Tashmë edhe opinioni i di mirë qëndrimet e secilit lider dhe parti politike. Arsyeja e kërkesës për pezullimin 120 ditorë të taksës, e shprehur nga kryetari Veseli, është shumë e qartë: ka një arsye themelore që ndërlidhet me

# ı koalicionin qeverisës



kërkesën e shprehur disa herë në mënyrë eksplicite nga partnerët tanë amerikanë. Kjo ka qenë baza dhe, po ashtu, fakti që Kosova tashmë është duke u parë si penguese e dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Nuk mendojmë se Kosova e meriton të quhet penguese duke pasur parasysh se Serbia ka qenë ajo palë që nuk ka respektuar në masën më të madhe marrëveshjet të cilat janë arritur në Bruksel. Por, sidoqoftë, tashmë edhe në kryeqytetet e shteteve mike të Kosovës është thënë, në një formë apo tjetër, që nuk po marrim pjesë në dialog në mënyrë të qëllimshme. Unë besoj se interesi i Kosovës është të dëshmojë një partneritet me shtetet mike dhe zhbllokimi i dialogut nuk do të thotë edhe arritje e marrëveshjes.

**"Epoka e re":** *Taksa nuk e rrezikon vazhdimin e koalicionit?*
**Krasniqi:** Nuk mund t'ju jap një përgjigje më të re prej asaj që është deklaruar deri më tash prej PDK-së dhe prej z. Veseli si lider i koalicionit qeverisës. Qëndrimi i tij tashmë dihet. Problemin nuk e kemi aspak me taksën ndaj Serbisë sepse, në fund të fundit, pa PDK-në ajo taksë nuk ishte vendosur. Çështja ka të bëjë vetëm me raportin e Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe shtetet mike të Bashkimit Evropian. Nëse në një moment do të rrezikohet seriozisht ky raport siç është thënë në raste të caktuara, atëherë besoj se secili politikan në Kosovë do ta trajtojë seriozisht një çështje të tillë. Por, për diçka të tillë nuk mund të paragjykojmë, prandaj taksa është vetëm një çështje e cila e ndërlidh koalicionin tonë dhe nuk është çështja kryesore dhe e vetme. Kemi edhe një serë çështjesh për të cilat kemi pajtim dhe funksionim normal.

**"Epoka e re":** *A është e gatshme PDK-ja ta braktisë qeverinë nëse rrezikohen raportet Kosovë - Amerikë?*
**Krasniqi:** PDK-ja vendimet e veta i merr në mënyrë të pavarur dhe jo duke u bazuar në kërkesat e kujtdo qoftë. Normalisht se i marrim parasysh zhvillimet të cilat mund të jenë në favor të Kosovës ose jo. Sido që të jetë, nuk dua të besoj që ka lider ose parti politike në Kosovë që në mënyrë të vetëdijshme e rrezikon raportin e Kosovës me Amerikën. Kjo është e patolerueshme, prandaj nuk besoj se do të mund të vijë deri aty situata.

**"Epoka e re":** *Ju jeni optimist se taksa do të pezullohet para se të rrezikohen këto raporte?*
**Krasniqi:** Taksa nuk është tema kryesore që i shqetëson qytetarët e Kosovës dhe taksa nuk është as tema kryesore që duhet t'i shqetësojë mediet e Kosovës, sepse rreziku i fokusimit kaq të madh te çështja e taksës e ka hequr fokusin prej qindra problemeve me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës çdo ditë.

**"Epoka e re":** *Pavarësisht prej këtyre çështjeve, si e shihni vazhdimin e procesit të dialogut në rast se nuk do të pezullohet taksa?*
**Krasniqi:** Kosova duhet ta luajë rolin e vet si partnere e besueshme e ShBA-së dhe BE-së edhe në kuptimin e rolit të saj në dialogun për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ajo që nuk do të duhej të ndodhte e që ndonjëherë është duke ndodhur është portretizimi i Kosovës si pengues i dialogut me Serbinë. Nuk besoj se kjo e dëshmon konstruktivitetin e vërtetë të Kosovës deri tash. Mendoj se kemi bërë hapat e duhur me miratimin e Ligjit për dialog, me miratimin e Platformës për dialog si dhe me formimin e ekipit negociues në mënyrë që ta shprehim vullnetin tonë për ta vazhduar këtë proces të dialogut dhe për t'i dhënë mundësi arritjes së një marrëveshje të pranueshme për vendin tonë. Se a do të ndodhë kjo dhe kur mund të ndodhë, nuk është një çështje që mund ta përcaktojmë sot. Është e rëndësishme që të kuptohet vullneti i shprehur nga institucionet kryesore të Kosovës për ta luajtur rolin tonë në këtë proces.

**"Epoka e re":** *Megjithatë, dy partitë opozitare, LDK-ja dhe Vetëvendosja, e kanë dërguar në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për dialog. Si e shihni këtë veprim dhe a prisni që Kushtetuesja ta kthejë mbrapsht ligjin?*
**Krasniqi:** Nuk jam ekspert kushtetues dhe nuk mund ta mohoj të drejtën e deputetëve që ta referojnë cilindo ligj për mendim në Gjykatën Kushtetuese. Sidoqoftë, partitë opozitare do t'i bënin shumë më shumë nder vendit sikur të ishin pjesë e procesit të dialogut edhe në ekipin negociues, edhe në komisionin mbikëqyrës që do të formohet në Kuvendin e Kosovës.

**"Epoka e re":** *A ndihet komod koalicioni qeverisës karshi kësaj opozite e cila ka paralajmëruar rrëzimin e qeverisë sapo të sigurohen votat?*
**Krasniqi:** Kjo nuk është aspak shqetësuese sepse nuk është kërkesë e sinqertë. Asnjëra prej partive opozitare nuk dëshiron zgjedhje dhe arsyet janë të ndryshme dhe kanë të bëjnë me kontekstet e tyre të brendshme. Por, përtej marketingut politik nuk besoj se ka asgjë të vërtetë. Përndryshe, Lista Serbe tashmë ua ka ofruar votat dhe bashkë me Listën Serbe, LDK-ja, Vetëvendosja, por edhe PSD-ja, do t'i kenë numrat e mjaftueshëm për mocion të mosbesimit ndaj qeverisë. Por, vetë fakti se një gjë e tillë nuk po ndodhë, tregon se ata nuk janë të sinqertë në kërkesën e tyre. Opozita nuk e ka rrezikuar dhe nuk e rrezikon këtë koalicion në asnjë mënyrë. Sa i përket kësaj opozite, besoj se koalicioni mund ta çojë mandatin deri në fund.

## Studentët e Universitetit 'Kadri Zeka' vizituan Prokurorinë Themelore në Gjilan

**Gjilan, 22 mars (ER)** - Në Prokurorinë Themelore në Gjilan të premten një grup studentësh nga Fakulteti Juridik "Kadri Zeka" kanë realizuar një vizitë studimore, të cilët kishin për qëllim njohjen në mënyrë të drejtpërdrejtë me këtë institucion.
Qëllim kryesor i kësaj vizite ishte edukimi dhe marrja e njohurive praktike dhe të drejtpërdrejta nga kjo prokurori, ku me këtë rast studentëve mirëseardhjen ua shprehu kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan, Jetish Maloku, si dhe prokurori i shtetit, Agron Uka, i cili edhe ligjëroi para tyre.
Kryeprokurori fillimisht e vlerësoi vizitën e tyre dhe të njëjtit i njoftoi mbi rolin, organizimin, funksionimin dhe kompetencat e kësaj prokurorie. Ndërkaq prokurori Agron Uka i ka njoftuar të pranishmit me procedurat sa i përket strategjisë së trajtimit të lëndëve, që nga pranimi i kallëzimeve penale, faza e hetimeve e deri te ngritja e aktakuzave, pushimi i hetimeve apo hedhja e kallëzimeve penale, si dhe përfaqësimi i rasteve penale në gjykata.
Takimi vazhdoi si bashkëbisedim i lirë, me ç'rast kryeprokurori dhe prokurori i shtetit iu përgjigjën interesit të studentëve, të cilët u fokusuan mbi aspekte të ndryshme, si marrëdhëniet e prokurorisë me gjykatat dhe institucionet e tjera të drejtësisë, organizatat ndërkombëtare, ligjet që e rregullojnë sistemin prokurorial, mënyrën e kryerjes së rasteve si dhe transparencën dhe llogaridhënien e këtij institucioni.



# Filluan punimet në segmentin e ri të rrugës nacionale Prishtinë - Mitrovicë

PRISHTINË, 22 MARS (ER) - Bashkë me kryeministrin Ramush Haradinaj, ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të premten mori pjesë në fillimin e punimeve në segmentin e ri, Lum Madh-Gojbule, të rrugës nacionale M2, Prishtinë - Mitrovicë, "Rruga e tre heronjve Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha".

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se kjo rrugë ka rëndësi të madhe strategjike dhe ekonomike, ngaqë lidhë Prishtinën me Mitrovicën, por edhe ekonominë e vendit me ekonomitë e shteteve fqinje.

I pari i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, duke iu adresuar të pranishmëve, ka thënë se investimet e kësaj ministrie tani po shtrihen në të gjitha rajonet e Kosovës, pa dallim.

Kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, e ka falënderuar kryeministrin Haradinaj dhe ministrin Lekaj për përkushtimin e treguar në përfundimin e këtij projekti që ka rëndësi për qytetarët e kësaj ane dhe qytetin e Vushtrrisë.

Ky segment i kësaj rruge ka gjatësi rreth 10 kilometra dhe kosto rreth 24 milionë euro. Bashkë me këtë segment dhe pjesën e mbetur deri në përfundim te "Rruga e tre heronjve Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu dhe Edmond Hoxha", projekti kap vlerën rreth 50 milionë euro të siguruara nga Fondi Saudit për Zhvillim, Fondi OPEC për Zhvillim dhe Banka Islamike për Zhvillim (segmenti Gojbule -Smrekonicë).



# Gjatë vitit 2018 Komuna e Prishtinës ka lëshuar 186 leje ndërtimore

PRISHTINË, 22 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, dhe drejtori i Urbanizmit, Ardian Olluri, kanë prezantuar të premten, në një konferencë për media, punën e kësaj drejtorie gjatë vitit 2018, planifikimet dhe projektet për vitin 2019, si dhe risitë në procedurat e aplikimit dhe pajisjes me leje ndërtimore.



Gjatë vitit 2018 Drejtoria e Urbanizmit ka trajtuar 2 749 kërkesa, prej të cilave 1 732 janë përfunduar. Janë lëshuar 186 leje ndërtimore, përkatësisht është lejuar sipërfaqe ndërtimore prej 869,019.99 m2. "Gjatë vitit 2018 janë pranuar 23 kërkesa për certifikata të përdorimit, kurse që nga viti 2000 deri tani janë lëshuar vetëm 71 leje përdorimi për 1 724 leje të lëshuara për këtë periudhë. Pjesë e lehtësimit për aplikimin dhe pajisjen me leje ndërtimore, përveç sistemit one-stop shop, është eliminuar edhe procedura e pajisjes me pëlqime për rregullimin e tokës ndërtimore, duke i përfshirë të njëjtat në dokumente për kushte ndërtimore. Në Drejtorinë e Urbanizmit është funksionale edhe një zyrë shërbyese informuese që ofron informata dhe ndihmon aplikuesit gjatë procesit të përgatitjes së dokumentacionit ndërtimor dhe aplikimit për leje ndërtimore", është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

Në funksion të rritjes së transparencës, përveç "permit tracking system" dhe publikimit të lejeve ndërtimore, tashmë bëhet edhe publikimi i të gjithë procesit me kushte ndërtimore, njoftimi publik, komentet e palëve, vendimet e drejtorisë dhe kushtet ndërtimore të propozuara. "Në këtë mënyrë u mundësohet që të gjitha palëve të interesit të kenë qasje në kohë të njëjtë lidhur me procesin dhe të kenë mundësi t'i japin komentet e tyre. Së shpejti, Drejtoria e Urbanizmit do ta fillojë publikimin e të gjitha objekteve të pajisura me certifikatë përdorimi dhe ato të cilat nuk janë të pajisura me këtë certifikatë", është theksuar në njoftimin e Komunës së Prishtinës.

# Matoshi bën thirrje për mbrojtje dhe përdorim racional të ujit

PRISHTINË, 22 MARS (ER) - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka marrë pjesë të premten në shënimin e 22 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Ujit dhe 23 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Meteorologjisë, e organizuar në Liqenin e Batllavës. Me këtë rast, ministri Matoshi dha një mesazh për institucionet e vendit dhe qytetarët, për ruajtjen dhe shfrytëzimin racional të ujit në vendin tonë. "Është momenti që të gjithë ta trajtojmë ujin ashtu siç duhet sepse nënkupton jetë dhe si vend kemi nevojë shumë të madhe që ta ruajmë sasinë e ujit, ta shfrytëzojmë në mënyrë sa më racionale, të kujdesemi si institucione, të kemi rezerva ujore për vendin tonë sepse secili prej jush e di, se vendi ynë është me rezervat më të pakta ujore në gjithë Evropën", ka thënë Matoshi, duke shtuar se motoja e këtij viti "Ujë për të gjithë" na



obligon të gjithëve që të punojmë në këtë drejtim. "Ju lus të punoni sa më shumë, të na ndihmoni sa më shumë, të dërgoni sa më shumë mesazhe te të gjithë për rëndësinë që ka uji, për rëndësinë që duhet t'i kushtojmë ruajtjes së rezervave ujore dhe për rëndësinë e ujit të pastër në mënyrë të veçantë", ka thënë ministri Matoshi.

Në shënim të kësaj dite është organizuar edhe një tryezë në të cilën janë prezantuar të arriturat dhe sfidat në fushën e ujërave në Kosovë.

# Në tri farmaci në Prishtinë janë sekuestruar qindra kilogramë barna ilegale

PRISHTINË, 22 MARS (ER) - Inspektorati Farmaceutik i Ministrisë së Shëndetësisë, pas inspektimeve ad hoc të kryera të enjten në mbrëmje në tri subjekte farmaceutike private, ka sekuestruar qindra kilogramë barna ilegale. Pas marrjes së informatës nga Njësie Hetuese e Krimeve Ekonomike e Policisë së Kosovës, se në një subjekt (garazh) privat dyshohet se ka barna ilegale, IF ka organizuar tri ekipe inspektorësh dhe me asistencë të Policisë së Kosovës ka kryer inspektimet në vendet e dyshuara për mbajtje të barnave ilegale.

Gjatë inspektimit inspektorët kanë gjetur qindra kilogramë barna ilegale të grupeve të ndryshme farmaceutike. Po ashtu, janë gjetur barna pa banderola, por me hyrje të rregullta (leje për autorizim), si dhe barna me banderola të Serbisë etj. Të gjitha këto barna janë evidentuar dhe konfiskuar nga Inspektorati Farmaceutik dhe me to do të procedohet sipas legjislacionit në fuqi.

Inspektorati Farmaceutik mbetet i përkushtuar për përmbushjen e përgjegjësive të tij, me qëllim që në tregun farmaceutik të Kosovës të qarkullojnë produkte të sigurta për përdorim të tyre.



# Policia arreston tre pjesëtarë të një grupi kriminal, konfiskon 99 armë zjarri

Policia e Kosovës (PK) ka arrestuar tre persona nën dyshimin e bazuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale si dhe ka konfiskuar 99 armë zjarri të llojeve të ndryshme, municion, por edhe medikamente, që dyshohet se ishin kontrabandë

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 MARS - Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit (DHKEK), ka arrestuar tre persona nën dyshimin e bazuar për kryerjen e veprave të ndryshme penale. Gjatë realizimit të hetimeve dhe zhvillimeve në terren, si pjesë e këtij operacioni policor janë përfshirë edhe Drejtoria Kundër Krimit të Organizuar (DKKO) dhe institucionet e tjera kompetente që merren me trajtimin e produkteve mjekësore. Personat e arrestuar janë: B. S., S. S. dhe F. H. "Pas angazhimit sistematik hetimor të zyrtarëve kompetentë nga Policia e Kosovës dhe aplikimit të teknikave të avancuara me masa të fshehta si dhe urdhëresave nga Gjykata Themelore në Prishtinë, ka rezultuar se kemi të bëjmë me një grup të organizuar, i përbërë nga personat e dyshuar, të përmendur më lart, të cilët janë ndaluar dhe u janë kontrolluar veturat që ishin në pronësi të tyre. Po ashtu është bërë kontrollimi i lokacioneve ku dyshohej se personat e dyshuar kanë fshehur (deponuar) barnat të cilat dyshohet se kanë qenë të kontrabanduara dhe të njëjtat janë shpërndarë nga të dyshuarit në fjalë, tek shitësit ambulantë dhe në barnatore të ndryshme në tërë Republikën e Kosovës", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.






Gjatë operacionit janë sekuestruar 29 pistoleta 'Glock Austria', 70 pistoleta 'Sig-Sauer', 303 copë fishekë të kalibrit 9 mm, 417 copë fishekë të kalibrit 7.65 mm, 5 copë fishekë të kalibrit 6.35 mm, tri vetura, paketime të ndryshme të barnave dhe detergjent të lëngshëm. "Policia e Kosovës do të ndërmarrë edhe veprime të tjera hetimore, pasi dyshohet se të dyshuarit kanë vepruar si grup kriminal i organizuar dhe i strukturuar dhe se mund të ketë edhe persona të tjerë të përfshirë në këtë rast. Pas intervistimit, të dyshuarit, me urdhër të prokurorit kompetent, janë dërguar në qendër të mbajtjes për 48 orë", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Për këtë aksion, drejtori i Departamentit për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit, Bashkim Spahiu, ka mbajtur të premten një konferencë për media. Ai ka treguar se pas informacioneve, hetuesit e këtij departamenti, në bashkëpunim edhe me hetuesit e Departamentit të Krimit të Organizuar, kanë kryer këtë operacion. Vetëm gjatë vitit 2018 Policia kishte konfiskuar 1 473 armë të llojeve të ndryshme dhe mbi 23 000 municione të kalibrave të ndryshme.




# Ministri Bytyqi: Kemi punuar përtej objektivave të Ministrisë së Arsimit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 MARS - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MAShT), me mbështetje të GIZ-CDBE (Zhvillimi i Kapaciteteve në Arsimin Fillor), ka organizuar të premten konferencën e rishikimit vjetor të planit strategjik të arsimit të Kosovës 2018.

Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, me këtë rast ka theksuar se kjo konferencë është mundësi e mirë për t'i diskutuar të gjeturat sa iu përket arritjeve dhe sfidave në sektorin e arsimit. Bytyqi ka falënderuar partnerët e Ministrisë së Arsimit për përkrahjen që po i japin realizimit të rishikimit vjetor të planit strategjik të arsimit të Kosovës dhe objektivave të tjera, të cilat dalin gjatë realizimit të planit vjetor. "Në sistemin arsimor duhet të kemi qasje e cila garanton cilësi të qëndrueshme. Kemi bërë punë të cilat kanë qenë përtej objektivave tona, në mënyre që të sigurojmë cilësi në arsim", ka thënë ministri Bytyqi, i cili ka folur edhe për zhvillimin profesional të mësimdhënësve, për avancimin e metodave të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, për kompletimin e infrastrukturës ligjore, për rritjen e gjithëpërfshirjes dhe për parandalimin e braktisjes në arsim.

Menaxheri i Programit "Politikat e BE-së në arsim", në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, Stergios Tragoudas, ka thënë se kjo ngjarje është mundësi që të vazhdohen përpjekjet për të punuar mbi parimet e cilësisë dhe transparencës. Tragoudas ka thënë se vetëdija për rëndësinë e cilësisë po rritet çdo ditë, por ndryshimet nuk mund të ndodhin shpejt, në veçanti në arsim.

Ndërsa përfaqësuesja e GIZ në Kosovë, Rrezarta Zhinipotoku, ka thënë se GIZ-i e ka mbështetur edhe vitin e kaluar zbatimin e rishikimit vjetor të planit strategjik të arsimit të Kosovës 2018, dhe duke marrë parasysh reformat nga viti i kaluar, është arritur hartimi i një raporti të suksesshëm.



# Ministri Shala e vendos Kosovën në fokus të investitorëve francezë

Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka bërë me dije të premten se raporti i fundit i Bankës Botërore ka treguar se ministria që drejton ka bërë reforma të thella në përmirësimin e klimës së të bërit biznes. "Kosova renditet e 10-ta në botë sa i përket regjistrimit të biznesit", ka theksuar ministri Shala

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ




**Prishtinë, 22 mars** - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka marrë pjesë të premten në simpoziumin lidhur me investimet në Kosovë, të organizuar nga Klubi Afarist France Albanie Bussiness (FAB) dhe Klubi Afarist Frankofon në Kosovë (KOCAF). Në fjalimin e tij në këtë simpozium, ministri Shala ka thënë se Kosova si një shtet i ri ka sfida të mëdha përpara vetes, të cilat kanë të bëjnë me shtetndërtimin dhe me krijimin e përvojave apo praktikave në mënyrë që të ecim hapave të sigurt të zhvillimit. Ai ka shtuar se Qeveria e Kosovës po bën hapa të rëndësishëm në adresimin e këtyre sfidave. "Raporti i fundit i Bankës Botërore ka treguar se ne si MTI kemi bërë reforma të thella në përmirësimin e klimës së të bërit biznes dhe Kosova renditet e 10-ta në botë sa i përket regjistrimit të biznesit", ka theksuar ministri Shala.

Gjithashtu, ai ka shtuar se sot ministria që drejton është në krijim e sipër të një infrastrukture moderne ligjore e cila është në përputhje me të gjitha direktivat evropiane. "Në Kosovë kemi një sistem taksiv më të lehtë dhe më të gjerë në rajon, që po na bënë më atraktivë për investitorët e jashtëm. Kosova po vazhdon të krijojë zona ekonomike më të gjithë infrastrukturën përcjellëse për t'iu ofruar kushte sa më të mira bizneseve që janë të interesuara të punojnë në Kosovë. Për Kosovën vendet frankofone, sidomos Franca, është ndër partneret kryesore politike dhe ekonomike të vendit dhe jam i lumtur sot t'ju them se kemi krijuar hapësirë për ta rritur bashkëpunimin ekonomik përmes krijimit të kushteve që këta investitorë ta kenë Kosovën një vend ideal për investime", ka potencuar Shala. Ai ka bërë me dije edhe faktin se tashmë është jetësuar Ligji për investime strategjike dhe se investitori i parë tashmë ka marrë statusin e investitorit strategjik dhe së shpejti do të fillojë investimin në energji me erë.

Më tej, ministri Shala ka sqaruar se Ligji për investime strategjike përmban lehtësira administrative, procedurale dhe investitorët potencialë e kanë rrugën e hapur. Ministri Shala u shpreh i kënaqur se do të ketë së paku një investitor francez që do të hyjë si investitor strategjik në kuadër të Ligjit për Investime Strategjike, i cili do të investojë në energji të ripërtëritshme, e që do të ndikojë për arritjen e standardeve të kërkuara nga Bashkimi Evropian në mënyrë që ta arrijmë 20 % e prodhimit të energjisë së ripërtëritshme.

Krahas investimeve strategjike, ministri Shala ka ripohuar se është duke punuar shumë që të rritet tregtia me vendet frankofone. "Tanimë kemi iniciuar bashkëpunimin me vendet e EFTA-së, ku kemi nënshkruar një memorandum bashkëpunimi dhe së shpejti do t'i hapim negociatat për marrëveshje të tregtisë së lirë me këto vende", ka thënë ai. Sipas ministrit Shala, këto iniciativa shkojnë paralelisht me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit e cila është nënshkruar me Bashkimin Evropian. "Jemi të interesuar që të gjitha barrierat tregtare që ekzistojnë në mes të vendit tonë dhe vendeve frankofone t'i eliminojmë në mënyrë që ta rrisim tregtinë dhe ta balancojmë raportin tregtar", ka thënë Shala. Po ashtu, si prioritet i përhershëm i MTI-së, sipas tij, është bashkëpunimi me ministritë e tjera për adresimin e nevojave të bizneseve në mënyrë që të përgatitet fuqia punëtore në përputhje me kërkesat e tyre.

Në fund të fjalimit të tij, ai edhe një herë i ka inkurajuar investitorët dhe këtë forum që të gjejnë mundësinë për të investuar në Kosovë. "Ju them me përgjegjësi të plotë se për çdo lloj vështirësie që keni, unë dhe MTI-ja do të jemi avokati juaj për çdo problem që shfaqet në afarizmin tuaj. Ne do të jemi të gatshëm dhe pranë jush në çdo çast për t'i aprovuar të gjitha kërkesat tuaja dhe t'i japim zgjidhje çdo problemi eventual", ishte përkrahja dhe inkurajimi i ministrit Shala për investitorët në përgjithësi.

# Kosova ka përmbushur të gjitha kërkesat e marrëveshjes së Brukselit për energji



**Prishtinë, 22 mars (ER)** - Si vazhdimësi e koordinimit ndërinstitucional për sektorin e energjisë, kryeministri i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të premten në takim ministrin e Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, përfaqësuesit e Ambasadës së Gjermanisë në Kosovë, përfaqësuesit e KfW, kryeshefin e KOSTT-it, Ilir Shala dhe përfaqësuesit e ZRRE-së, me të cilët ka biseduar për zhvillimet në sektorin e energjisë, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit të energjisë elektrike në vend dhe kyçjen e burimeve të ripërtëritshme.

Në këtë takim kryeministri Haradinaj ka falënderuar përfaqësuesit e Bankës Gjermane për Zhvillim (KfW) dhe të Ambasadës së Gjermanisë për kontributin e tyre në fusha të ndryshme, veçmas në sektorin e energjisë dhe ka kërkuar më shumë përkushtim nga dikasteret përkatës institucionalë në punët dhe sfidat për furnizimin e rregullt me energji elektrike, përmirësimet në rrjet dhe partneritetin me institucionet ndërkombëtare në këtë fushë.

Në këtë takim, kryeministri Haradinaj ka thënë se nga puna e deritanishme u kuptua që Kosova ka përmbushur të gjitha kërkesat e marrëveshjes së Brukselit për energji, përkundër palës serbe që po gjen justifikime për bllokimin e zbatimit të marrëveshjes. "Kosova ka përmbushur pjesën e saj të përgjegjësisë në raport me partnerët ndërkombëtarë në energji dhe ka bazë të mirë legjislative për pranimin e investimeve të reja në energjinë alternative", ka deklaruar kryeministri Haradinaj në fjalën e tij. Po në takim është theksuar nevoja që Kosova të ketë një qasje më proaktive për ta përmirësuar pozitën e saj sa iu përket institucioneve ndërkombëtare të sektorit të energjisë, si një nga fushat jetike të mirëqenies së qytetarëve. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e KfW, të Ambasadës së Gjermanisë, theksuan mbështetjen për Kosovën në fusha të ndryshme dhe në sektorin e energjisë.

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur seancë të jashtëzakonshme

# Kuvendi miraton rezolutën për pezullimin e lojërave të fatit

Me 74 vota për dhe asnjë kundër, Kuvendi i Kosovës ka miratuar të premten rezolutën e propozuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK-ja), ku kërkohet pezullimi i aktiviteteve të kazinove dhe lojërave të fatit si dhe plotësim-ndryshimi i ligjit përkatës. Nëpërmjet rezolutës obligohet qeveria t'i nisë procedurat ligjore për pezullimin e lojërave të fatit deri në ndryshim të ligjit, ndërsa brenda 30 ditëve ta sjellë ligjin që ndalon lojërat e fatit

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 22 MARS - Me kërkesën e 49 deputetëve, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka mbajtur të premten seancë të jashtëzakonshme, në të cilën ka miratuar rezolutën lidhur me pezullimin e aktivitetit të kazinove dhe lojërave të fatit dhe plotësim-ndryshimin e ligjit përkatës. Në cilësi të iniciuesit, projektrezolutën e paraqiti shefi i grupit parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Avdullah Hoti, duke arsyetuar edhe iniciativën për propozim. Hoti ka thënë se lojërat e fatit janë lojëra të zhvatjes së qytetarëve dhe se askush nuk pasurohet nga bizneset e lojërave të fatit. Projektrezoluta u përkrah edhe nga përfaqësuesit e grupeve të tjera parlamentare që morën fjalën në seancë. Kështu, Memli Krasniqi (PDK), Glauk Konjufca (LV), Ahmet Isufi (AAK), Bilall Sherifi (Nisma) dhe Duda Balje 6+, i dhanë mbështetje idesë për t'i mbyllur lojërat e fatit dhe rezolutës së propozuar.

Deputeti i PSD-së, Faton Topalli, ka adresuar kritika ndaj iniciuesve lidhur me përmbajtjen e kësaj iniciative. Sidoqoftë, grupet u pajtuan të shkohet në votim të rezolutës, pa debat parlamentar. Pas harmonizimit të tekstit midis grupeve parlamentare, me 74 vota për dhe asnjë kundër, Kuvendi miratoi rezolutën e propozuar. Nëpërmjet rezolutës obligohet qeveria t'i nisë procedurat ligjore për pezullimin e lojërave të fatit deri në ndryshim të ligjit, ndërsa brenda 30 ditëve ta sjellë ligjin që ndalon lojërat e fatit.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka theksuar nevojën që vendimi i Kuvendit të jetë i zbatueshëm dhe të mos luhet me ndjenjat e qytetarëve. "Kemi një iniciativë të deputetëve, për fat të mirë nga shumica e grupeve parlamentare, është një nga iniciativat për mbyllje të lojërave të fatit, të mashtrimit që po dëmton familjet dhe qytetarët. Fati i qytetarëve tanë nuk janë kazinotë. Lojërat e fatit duhet të dalin jashtë nga qendra, për të mos thënë të mbyllen krejt... mënyrë ideale është largimi i tyre jashtë qyteteve. Duhet të kihet parasysh që Kosova nuk do të lejojë të ketë krim të organizuar", ka thënë Veseli pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.

Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka thënë se çdo vendim i Kuvendit për ta do të jetë obligues.

Kryeministri Ramush Haradinaj ka përkrahur rezolutën lidhur me pezullimin e aktiviteteve të kazinove dhe lojërave të fatit dhe plotësim-ndryshimin e ligjit përkatës. Duke bërë me dije se ditë më parë, si kryeministër i vendit, ka kërkuar inicimin e procedurave të nevojshme brenda ekzekutivit, të cilat do të rezultonin me mbylljen dhe pezullimin e aktiviteteve të kazinove dhe lojërave të fatit. "Përballë kësaj gjendjeje ne nuk do të lejojmë që këto vende të jenë arenë e krimit dhe të marrin jetë njerëzish", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka bërë me dije se për mbledhjen e ardhshme të qeverisë, Zyra e Kryeministrit ka përgatitur ligjin i cili do ta shfuqizojë ligjin ekzistues dhe do t'i ndalojë lojërat e fatit.



## Deputetët e Listës Serbe kthehen në Kuvend

Lista Serbe ka njoftuar se deputetët e saj të premten "shkurtimisht" morën pjesë në seancën e Kuvendit të Kosovës në mënyrë që të parandalojnë që për arsye procedurale t'u merren mandatet e deputetëve.

Ata theksuan se janë të obliguar të mbrojnë zëvendësimin e tyre me, siç i quajtën, 'serbë privatë' të Hashim Thaçit dhe Ramush Haradinajt. Përmes një komunikate për media, kjo parti thotë se kanë përmbushur angazhimin formal që të mos mungojnë në seanca më tepër se gjashtë muaj. Sipas tyre ishte koha për të parandaluar përsëritjen e skenarit në të cilin në postin e ministrit të Bujqësisë erdhi një person i panjohur pa ndonjë peshë politike. Deputetë të Listës Serbe të Goran Rakiqit nuk kanë marrë pjesë në seanca parlamentare që kur Qeveria e Kosovës vendosi taksën 100 për qind ndaj produkteve me origjinë nga Serbia dhe Bosnja.

## MBPZhR-ja, mbështetje për projektet bujqësore të Obiliqit

PRISHTINË, 22 MARS (ER) - Përmes programeve zhvillimore të këtij viti, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural do të ofrojë mbështetje për shumë sektorë të bujqësisë, duke ndikuar kështu në fuqizimin e mëtejmë të sektorit në mbarë vendin. Në kuadër të këtyre programeve mbështetje do të gjejnë edhe fermerët e Komunës së Obiliqit. Kështu është shprehur ministrja e MBPZhR-së, Dijana Ziviq, gjatë takimit që pati me kryetarin e Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, të cilin e ka njoftuar më hollësisht për Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural për vitin 2019 dhe për skemat e reja të mbështetjes.

Ministrja Ziviq ka konfirmuar gatishmërinë e saj për ta thelluar bashkëpunimin me këtë komunë, me qëllim të zhvillimit të mëtejmë të sektorit të bujqësisë në këtë rajon. Nga ana e tij, kryetari i Obiliqit, Xhafer Gashi, e falënderoi ministren për mbështetjen që MBPZhR-ja ka dhënë për këtë komunë, me qëllim të zhvillimit të mëtejmë të sektorit të bujqësisë. Kryetari Gashi e njoftoi ministren edhe për sfidat dhe të arriturat në këtë sektor dhe me këtë rast shprehi përkushtimin e tij për të realizuar projekte zhvillimore në këtë sektor.



# I jepet lamtumira e fundit nënës së heroit Edmond Hoxha






Junik, 22 mars (ER) - Të premten në Junik është varrosur Nurije Hoxha, nëna e heroit të kombit Edmond Hoxha, e cila ka ndërruar jetë të enjten në moshën 90-vjeçare. Në ceremoninë e varrimit ka marrë pjesë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, deputetja e PDK-së, Safete Hardergjonaj, kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi dhe përfaqësues të tjerë të partive politike.



Para të pranishmëve të shumtë, kryetarë të komunave, deputetë, familjarë të bashkëluftëtarëve të Edmondit, Hakif Zejnullahut, Ilir Konushevcit dhe Zahir Pajazitit, si dhe personaliteteve të tjera, kryeministri Haradinaj ka thënë se sot ka dhimbje Juniku, Dukagjini dhe tërë Kosova. "Po i japim lamtumirën e fundit nënës Nurije, nënës së heroit të kombit Edmond Hoxha dhe nënës së atdhetarit të shquar, të burgosurit politik Xhavit Hoxha, njëkohësisht nënës së të gjithë luftëtarëve, gjithë atyre që janë përpjekur për liri", ka thënë Haradinaj. Me këtë rast, kryeministri Haradinaj ka thënë se ndihet pak më i lehtësuar për faktin se fizikisht është në Junik për t'i dhënë lamtumirën nënës Nurije, e cila ishte shembull i një nëne shqiptare që ka rritë djem, jo për vete, por për atdheun.

Në nderim të nënës së heroit të kombit, Edmond Hoxha, në Kuvendin Komunal të Junikut është mbajtur një mbledhje përkujtimore, në të cilën është vlerësuar lart kontributi i saj.

# Shkolla 'Ismet Jashari - Kumanova' në Temeqinë pajiset me inventar



MALISHEVË, 22 MARS (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, së bashku me drejtorin e Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi, dhe donatorin, Burim Hazrolli nga fshati Banjë, kanë vizituar Shkollën Fillore të Mesme të Ulët 'Ismet Jashari - Kumanova' në Temeqinë. Begaj ka shprehur falënderimin për Burim Hazrollin për kontributin që po e jep për inventarizimin e shkollave me banka, karrige, me mjete kuzhine për shkolla, kompjuterë dhe në lidhje bashkëpunimi me komuna të shtetit gjerman si Komuna e Wagenhofen nga rrethina e qytetit të Munihut.

Ndërsa drejtori i DAE-së në Malishevë, Blerim Thaçi, ka kërkuar nga udhëheqja e shkollës, mësimdhënësit dhe nxënësit, për një punë edhe më të shtuar dhe më cilësore për mësimnxënie dhe mësimdhënie pasi, sipas tij, shkolla së shpejti do të pajiset edhe me mjete digjitale të informatikës dhe kabinete të lëndëve shkencore, që do t'u mundësojnë nxënësve të jenë konkurrentë me të tjerët edhe në tregun e punës për të ardhmen.

Këtë donacion për ShFMU 'Ismet Jashari - Kumanova' e ka dhënë komuna Wagenhofen nga rrethina e qytetit të Munihut, për institucionet arsimore në Komunën e Malishevës. Donacioni u ndihmua nga firma "Hazrolli" nga fshati Banjë, e cila vepron në Gjermani. Ndërsa transportin e këtij donacioni e ka ndihmuar Komuna e Malishevës. Kjo ishte vetëm pjesa e parë e donacionit, kurse pritet shumë shpejt edhe pjesa e dytë e donacionit nga po e njëjta firmë dhe donator.

# Bëhet riinxhinjerimi i Zyrës Kadastrale Komunale në Vushtrri



Vushtrri, 22 mars (ER) - Duke aspiruar ngritjen e kualitetit të shërbimeve të cilat i ofrojnë zyrat kadastrale komunale për qytetarët dhe institucionet e Republikës së Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës ka trajtuar secilën mënyrë për ofrimin e ndihmës adekuate për këto zyra.

Kjo është arritur përmes investimeve në trajnime për stafin komunal që kryejnë punë kadastrale, po ashtu edhe përmes investimeve të drejtpërdrejta për ngritjen e kapaciteteve teknologjike dhe profesionale nëpër zyrat kadastrale komunale.

Së fundmi Agjencia Kadastrale e Kosovës, me përkrahje të Autoritetit Norvegjez për Kadastër dhe Hartografi "Kartveket", ka financuar riinxhinjerimin e Zyrës Kadastrale Komunale në Vushtrri. Si pjesë e investimeve të cilat janë mbuluar me projektin e riinxhinjerimit të Zyrës Kadastrale Komunale në Vushtrri janë punët rinovuese, sistemi i ri i nxehjes, ventilimi i ri, mbrojtja nga zjarri, arkivi, orenditë dhe pajisjet e TI-së të cilat nevojiten për të siguruar një rrjedhë efikase të punës për stafin e Zyrës Kadastrale Komunale.

Objektiv i riinxhinjerimit është që t'i përmirësojë shërbimet ndaj qytetarëve dhe të përdoret organizimi i ri me zyrë pritëse/operuese dhe procedurat e standardizuara, në mënyrë që transaksionet të jenë më sistematike, efikase dhe transparente. AKK-ja deri më sot ka investuar në riinxhinjerimin e 20 Zyrave Kadastrale Komunale në territorin e Republikës së Kosovës.

# 40 kompani ofrojnë 500 vende pune në Gjilan



GJILAN, 22 MARS (ER) - Në Komunën e Gjilanit është hapur edicioni i dytë i Panairit të Punës në të cilën kanë marrë pjesë 40 kompani nga sektorë të ndryshëm.

Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik në Gjilan, Valbona Tahiri, ka bërë me dije se kompanitë pjesëmarrëse ofrojnë rreth 500 vende pune.

"Ky panair dëshmon se ka vende pune në ndërmarrjet e Komunës së Gjilanit dhe kohët e fundit mundësitë për të përgatitur profesionalisht një punëkërkues janë shumë më të mëdha duke iu falënderuar partnerëve tanë MPMS, GIZ dhe të tjerëve", ka thënë Tahiri.

Panairi i Punës në Gjilan është organizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës (APRK), Agjencinë për Zhvillim Rajonal - Lindje dhe Zyrën Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).

# Lëvizjet nacionalçlirimtare dhe përdorimi i gabueshëm i fjalës 'ilegal'



Bardhyl MAHMUTI

Është bërë e zakonshme që në përvjetorët e ngjarjeve të vitit 1981 të theksohet roli i "organizatave patriotike ilegale". Madje, me një nostalgji të veçantë përdoren termet "ilegalisht", "ilegalja", "ilegaliteti" dhe nocione të tjera që rrjedhin nga fjala "ilegal". Përmasat që ka marrë përdorimi i këtij termi imponon hapjen e debatit që njëherë e përgjithmonë të ketë një qartësi se çka mbulojnë këto terme në aspektin kuptimor.

Qëllimi i këtij shkrimi nuk është polemik, për këtë arsye nuk do të citoj asnjë autor që përdor apo arsyeton përdorimin e këtij termi. Nëse e shoh të nevojshme në të ardhmen, mund të përdoren edhe emrat e përveçëm.

Në fillim po përmend arsyetimin e mbështetësve të përdorimit të këtij termi me atë se "termi 'ilegal' është ngulitur në fjalorin e ligjërimit të zakonshëm dhe atë shkencor, studiues, e cila kuptohet si formë e veprimit të fshehtë të organizatave të Lëvizjes Kombëtare kundër regjimit jugosllav".

Përdorimi nga një numër i madh i njerëzve i një termi për një dukuri të caktuar nuk e arsyeton përdorimin e tij, nëse ky term është i gabueshëm. Madje, edhe në rastin kur të gjithë njerëzit e një shoqërie të caktuar përdorin një arsyetim të caktuar për një çështje, kjo nuk ia shton saktësinë.

Është i njohur "shembulli i baticës". Për mijëra vjet shoqëritë njerëzore që kanë jetuar përgjatë brigjeve të detit janë munduar ta shpjegojnë fenomenin e baticës. Është interesant se shumica e popujve që na kanë lënë botëkuptimet e tyre rreth kësaj çështjeje dëshmojnë për një qasje pak a shumë të ngjashme: janë munduar ta gjejnë shkakun e baticave në thellësi të detit. Për t'i forcuar bindjet e tyre, kanë imagjinuar perënditë e detit, të cilët, kur zemëroheshin me sjelljen e njerëzve (e zemërimin e kishin ciklik!), provokonin baticën e detit! Kishin mundur ta vazhdojnë hulumtimin e tyre në det edhe për mijëra vjet të tjera dhe me tërë teknikën që ka aktualisht njerëzimi nuk do të gjenin të vërtetën në fund të detit. Këndvështrimi ishte i gabuar! U dashtë të ndryshohet këndvështrimi dhe të shihej ndikimi i hënës në tokë për ta shpjeguar shkencërisht fenomenin e baticës. Mund të ketë ende njerëz që besojnë se perënditë e detit krijojnë baticën dhe nuk ngurrojnë të bëjnë sakrifica për ta zbutur zemërimin e perëndive, me arsyetim se kështu kanë besuar të parët e tyre.

Prandaj, përdorimi i gjerë që ka termi "ilegal" si "formë e veprimit të fshehtë të organizatave të Lëvizjes Kombëtare kundër regjimit jugosllav" nuk ia shton saktësinë këtij termi.

Ajo që është thelbësore për problematikën e mësipërme ka të bëjë me faktin se çështja e legalitetit/ilegalitetit nuk ka për kriter vlerësimi formën e veprimtarisë, por ligjshmërinë e një veprimi.

Kur kemi të bëjmë me ligjshmërinë e veprimeve që shkëputën territoret shqiptare nga Shqipëria dhe u ndanë si plaçkë shteteve fqinje, të gjithë veprimtarët për gjatë më shumë se një shekulli e kanë cilësuar si të paligjshme. I njëjti qëndrim ka qenë edhe në rastin kur Jugosllavia komuniste nuk e zbatoi vullnetin e popullit të Kosovës që të bashkohet me Shqipërinë dhe shkeli vendimet e Rezolutës së Bujanit ku delegatët shqiptarë, serbë, malazezë dhe boshnjakë, pjesëmarrës të kësaj Konference, ishin përcaktuar qartë në përputhje me të drejtën e kombeve për vetëvendosje. Prandaj, pushteti komunist jugosllav në territoret shqiptare ishte ilegal, edhe pse vepronte haptas. Ndërsa, të gjitha veprimet e kryera kundër këtij pushteti, qoftë haptas, qoftë fshehtas, ishin veprime të ligjshme në përputhje me të drejtën e kombeve për vetëvendosje, që ishte një nga parimet themelore të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe konsiderohet vlerë universale.

Nëse çështjen e "legalitetit/ilegalitetit" e shohim në raport me lëvizjet nacionalçlirimtare në botë, do të bindemi për qasjen e gabueshme që është instaluar në terminologjinë që përdoret për lëvizjen kombëtare të shqiptarëve që kanë vepruar kundër pushtetit ilegal të Jugosllavisë në territoret tona.

Duke u nisur nga fakti se "legaliteti/ilegaliteti" shndërrohen në objekt të luftës në mes palës që ka pushtuar territorin e caktuar dhe atyre që angazhohen për ta çliruar nga okupatori, termi "ilegal" shndërrohet në fjalën thelbësore që i ndan dy kampet.

Përderisa të gjitha organizatat dhe lëvizjet nacionalçlirimtare anekënd botës okupimin e territorit të tyre dhe mosrespektimin e të drejtës për vetëvendosje e konsiderojnë "ilegal" dhe pushtetin që nuk ka respektuar vullnetin e popullit e cilësojnë si "pushtet ilegal në përputhje me të drejtën ndërkombëtare", pushteti i instaluar përpiqet t'i njollosë lëvizjet dhe organizatat çlirimtare si të ishin struktura "ilegale", për arsye se nuk respektojnë ligjet dhe rendin e vendosur nga ai.

Një nga orientimet politike të lëvizjeve apo të organizatave çlirimtare në botë është këmbëngulja e tyre që ta fitojnë legalitetin në shkallën ndërkombëtare dhe ta prezantojnë pushtetin si pushtet ilegal.

Falë vendosmërisë së tyre të madhe lëvizjet nacionalçlirimtare në botë fituan legalitetin ndërkombëtar edhe përmes të drejtës ndërkombëtare. Në pikën 2 të Rezolutës 1514 të Asamblesë së Përgjithshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, të datës 14 dhjetor 1960, thuhet qartë se "të gjithë popujt kanë të drejtë që lirshëm të vetëvendosin; në përputhje me këtë të drejtë ata përcaktojnë lirshëm statusin e tyre politik dhe ndjekin në mënyrë të lirë zhvillimin e tyre ekonomik, social dhe kulturor".

Mjafton të lexohen programet, kartat, kushtetutat apo statutet e këtyre organizatave dhe lëvizjeve çlirimtare për t'u bindur se askund nuk mund të gjejmë identifikimin e tyre si "organizata ilegale" ose "lëvizje ilegale". Përkundrazi, si "ilegal" përkufizohen veprimet e palës tjetër, ligjet e palës tjetër, prania politike, ushtarake dhe policore e palës tjetër.

Vetëm ne bëjmë përjashtim! Identifikojmë veten si "ilegalë" dhe organizatën (lëvizjen) tonë çlirimtare e cilësojmë si "ilegale".

Mosnjohja e përmbajtjes adekuate të këtij termi ka bërë që në disa raste përdorimin e këtij termi për veten tonë ta bëjmë me mburrje!

Ta përkufizosh veten si "ilegal" në raport me Jugosllavinë në tërësi, ose me Serbinë, me Maqedoninë apo me Malin e Zi veç e veç, është gabimi më i madh që mund të bëjmë, sepse u japim "legalitetin" pushtimit të territoreve tona dhe mosrespektimit të së drejtës për vetëvendosje të popullit shqiptar.

As ndikimi që ka pasur një film i realizuar në Shqipëri në vitin 1976, i titulluar "Ilegalët", që trajtonte veprimtarinë antifashiste gjatë Luftës së Dytë Botërore, as mbështetja në definicionet e cilitdo fjalor, nuk i jep saktësi përdorimit të gabueshëm të termit "ilegal" në raport me ne dhe organizatat (lëvizjet) që kishin për qëllim çlirimin kombëtar nga Jugosllavia.

Nëse kemi parasysh se në rrafshin e politikës ndërkombëtare cilësimi i një organizate si "organizatë ilegale" ka konotacion tejet negativ, për arsyes se në këtë kategori futen organizatat që merren me trafikim të drogës, të armëve, të njerëzve, të organeve njerëzore etj. duhet të ndërpritet përdorimi i gabueshëm i këtij termi. Në të kundërtën i bëjmë shërbim, në mënyrë të pavetëdijshme, propagandës antishqiptare. **(Vijon)**

## Përkujtohet heroi i kombit, Asllan Fazliu

PRISHTINË, 22 MARS - Heroi i kombit, Asllan Fazliu, është përkujtuar të premten në 20-vjetorin e rënies.

Në një akademi përkujtimore është thënë se heroi Fazliu me një dashuri të jashtëzakonshme për atdheun është bërë pjesë e historisë së lavdishme të kombit, duke iu bashkuar luftës së Adem Jasharit, që nga fillimi i saj.

Në akademinë përkujtimore të organizuar nga presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kryetari i komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka thënë se heroi Asllan Fazliu kishte një vetëmohim, një trimëri dhe guxim deri në vdekjen e tij.

Ndërsa, kryetari i Shoqatës së Familjeve të Dëshmoreve, Xhavit Jashari, ka thënë se pushka e Asllan Fazliut ishte ndër të parat që iu bashkua thirrjes së Adem Jasharit.

Në anën tjetër, Sabit Syla, drejtor i Institutit të Historisë, ka thënë se Asllan Fazliu, kishte mobilizuar ushtarët e UÇK-së, duke ndërmarrë kështu një sërë aksionesh kundër forcave serbe.

Në këtë akademi ka folur edhe e bija e heroit Fazliu, Biondina Fazliu, e cila ka thënë se babanë e saj e njeh vetëm nëpërmjet fotografisë.

Asllan Fazliu gjatë luftës mbante nofkën "Luani". Këtë nofkë ia kishte lënë komandanti Ilaz Kodra, i cili pastaj edhe e kishte emëruar udhëheqës të UÇK-së për Gradicë.



# Udhëheqësit botërorë kritikojnë njoftimin e Trumpit për Rrafshnaltën Golan

Shumë liderë botërorë kanë kritikuar njoftimin e presidentit të ShBA-së, Donald Trump se Shtetet e Bashkuara do të njohin sovranitetin izraelit mbi Rrafshnaltën e Golanit, territor ky i pushtuar nga Izraeli në luftën gjashtëditore të vitit 1967 dhe kontrollohet nga Izraeli që nga ajo kohë

UASHINGTON, 22 MARS - Udhëheqësit botërorë po kritikojnë njoftimin e presidentit të ShBA-së, Donald Trump se Shtetet e Bashkuara do të njohin sovranitetin izraelit mbi lartësitë e Golanit.

Ministria e Jashtme e Sirisë tha të premten se njoftimi i presidentit Trump "është i papërgjegjshëm dhe nuk ndryshon faktin se Golani ishte dhe do të mbetet arab dhe sirian". Një burim i Ministrisë së Jashtme i tha agjencisë zyrtare të lajmeve të Sirisë SANA se njoftimi "pasqyron qartë mospërfilljen e ShBA-së për legjitimitetin ndërkombëtar dhe shkeljen flagrante të ligjit amerikan".

Rrafshnalta Golan u pushtua nga Izraeli në luftën gjashtëditore të vitit 1967 dhe kontrollohet nga Izraeli që nga ajo kohë.

Presidenti turk, Tayyip Erdogan tha se njoftimi i Trumpit e ka sjellë rajonin "në prag të një krize të re dhe tensioneve të reja". Ministri i Jashtëm turk Mevlut Çavusoglu u tha anëtarëve të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik në Stamboll se sulmet sistematike të Izraelit ndaj Xhamisë Al-Aqsa prej vitesh janë prova që Izraeli nuk ka respekt për besimet dhe vendet e shenjta ose tolerancën për të jetuar së bashku. Çavusoglu shtoi se "Komentet e papranueshme të presidentit Donald Trump mbi Rrafshnaltën Golan ushqejnë këtë mentalitet të deformuar".

Shefi i Lidhjes Arabe, Ahmed Aboul Gheit, gjithashtu kritikoi njoftimin, duke thënë, "Asnjë vend, pavarësisht se sa e rëndësishme është, mund të marrë një vendim të tillë".

Këshilli i Bashkëpunimit të Gjirit, një grup prej gjashtë monarkish arabe, tha se deklarata e presidentit Trump "nuk do të ndryshojë realitetin që Rrafshnalta arabe e Golanit është tokë siriane e pushtuar nga Izraeli me forcë ushtarake dhe minon shanset për arritjen e një paqeje të drejtë dhe gjithëpërfshirëse".

Ministria e Jashtme e Egjiptit e dënoi deklaratën e presidentit Trump, duke përmendur rezolutën 497 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, e cila kundërshton aneksimin e territorit nga Izraeli. Ministria theksoi se udhëheqësit globalë "duhet t'i respektojnë rezolutat me legjitimitet ndërkombëtar dhe Kartën e Kombeve të Bashkuara në lidhje me papranueshmërinë e marrjes së një territori me forcë".

Ministri i Jashtëm iranian Mohammad Javad Zarif tha se "Vendimet personale të Trumpit do të sjellin krizë në rajon".

Bashkimi Evropian theksoi se nuk e njeh sovranitetin e Izraelit mbi zonën e kontestuar. "Pozicioni i BE-së nuk ka ndryshuar", i tha një zëdhënëse e BE-së agjencisë Reuters.

Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, tha se BE-ja nuk ka ndryshuar qëndrim sa i përket Rrafshnaltës së Golanit, një ditë pasi presidenti i ShBA-së, Donald Trump tha se është koha që SHBA-ja të njohë sovranitetin e Izraelit në atë rajon.

"Pozicioni i Bashkimi Evropian është i njohur dhe nuk ka ndryshuar", tha Tusk në një konferencë për media.

Rusia shprehu shpresën se thirrja e Trumpit për njohjen e sovranitetit të Izraelit nuk do të miratohet. "Tani për tani, kjo është vetëm një thirrje", tha zëdhënësi i Kremlinit, Dmitri Peskov.

Presidenti Trump e bëri njoftimin të enjten nëpërmjet Twitterit, duke thënë se Rrafshnalta Golan "është me rëndësi kritike strategjike dhe të sigurisë për shtetin e Izraelit dhe stabilitetin rajonal!"

Komentet erdhën ndërkohë që sekretari i Shtetit, Mike Pompeo ishte në Jerusalem, duke u bërë zyrtari më i lartë amerikan që viziton Murin Perëndimor, një pjesë e qytetit mbi të cilën kanë pretendime si izraelitët, ashtu edhe palestinezët në Jerusalem.

Vizita u pa si një sinjal se Shtetet e Bashkuara po shprehin njohje të heshtur për pretendimin e Izraelit, ndërkohë që u pasua menjëherë nga njoftimi për Rrafshnaltën Golan.

Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka akuzuar Iranin se përpiqet të ndërmarrë sulme kundër Izraelit nga Rrafshnalta Golan, duke thënë "Mendoj se për këtë arsye dhe për shumë të tjera, ka ardhur koha që komuniteti ndërkombëtar të njohë kontrollin izraelit mbi Golan dhe faktin se Rrafshnalta Golan do të mbetet gjithmonë pjesë e shtetit të Izraelit".

Udhëheqësi izraelit përshëndeti vendimin e presidentit Trump pak pas njoftimit.

"Presidenti Trump sapo ka bërë një akt historik", tha kryeministri Netanyahu, pasi i telefonoi udhëheqësit amerikan. "Mesazhi që presidenti Trump i ka përcjellë botës është se ShBA-ja qëndron përkrah Izraelit. Ne jemi shumë mirënjohës për këtë mbështetje", tha ai.

Javën e kaluar, në raportin për të drejtat e njeriut, Departamenti i Shtetit nuk kishte përdorur shprehjen Rrafshnalta "e pushtuar" Golan, por duke e quajtur territorin thjesht "i kontrolluar nga Izraeli". Sekretari i Shtetit Pompeo tha në komentet për shtyp se ndryshimi në frazeologji nuk ishte i rastësishëm dhe se pasqyronte realitetin në terren - faktin që Izraeli e kontrollon këtë territor.

Izraeli e aneksoi këtë territor në vitin 1981. Por komuniteti ndërkombëtar nuk e ka njohur aneksimin dhe e konsideron Rrafshnaltën Golan një territor të pushtuar.



AP

## Zelanda e Re kujton viktimat e sulmit në xhami

WELLINGTON, 22 MARS - Qytetarë të Zelandës së Re iu bashkuan faljes së Xhumasë në qytetin Kristçërç, në kujtim të 50 njerëzve të vrarë nga të shtënat në dy xhami, të premten e kaluar.

Në mesin e të tubuarve ishte edhe kryeministrja Jacinda Ardern.

"Zelanda e Re mban zi me ju. Ne jemi një", tha ajo.

Australiani Brenton Tarrant, 28 vjeç, i vetëpërshkruar si supremacist i bardhë, u akuzua për vrasjet në xhami.

Ai do të paraqitet në gjykatë më 5 prill.

Kryeministrja Ardern mori vendim këtë javë që Zelanda e Re t'i ndalojë të gjitha llojet e armëve gjysmë-automatike dhe pushkët me shënjestrim.

"Historia jonë ndryshoi përgjithmonë. Tani, edhe ligjet tona do të ndryshojnë", tha Ardern.

Sulmuesi i xhamive e ka transmetuar drejtpërdrejt në Facebook aktin e tij.

Të martën, Facebook tha se videoja e sulmuesit është shikuar më pak se 200 herë gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë dhe rreth 4,000 herë përpara se është hequr nga Facebook-u.



Michelle Hyslop (AFP)

FORCA JONË

*** Viti VIII • Nr. 77 • 8 Mars 2019 • Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës ***

# Ministri Berisha dhe komandant Rama pritën delegacionin e lartë të NATO-s

Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha dhe komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Rrahman Rama pritën sot në Ministrinë e Mbrojtjes një delegacion nga Aleanca Veri-Atlantike(NATO), në krye me Jonathan Parish, zëvendës asistent i Sekretarit Gjeneral të NATO-s për Operacione si dhe drejtorin e Operacioneve dhe Misioneve të NATO-s, z. Michel Soula. Ministri Berisha dhe gjeneral Rama zhvilluan takime të ndara me delegacionin e NATO-s, në të cilat u bisedua kryesisht për situatën e sigurisë në Kosovë e rajon, zhvillimet rreth tranzicionit të FSK-së, marrëdhëniet Kosovë – NATO dhe perspektivën e këtyre marrëdhënieve në të ardhmen.




Krerët e FSK-së e njoftuan drejtorin e Operacioneve të NATO-s mbi zhvillimin e FSK-së, planet për të ardhmen, rikonfirmuan vullnetin e Kosovës për avancimin e marrëdhënieve me KFOR-in, NATO-n, si dhe konfirmuan vendosmërinë e Kosovës për anëtarësim në NATO.

# Vizitë e senatorëve të SHBA-ve në FSK



Më 17.02.2019, në Komandën e Forcave Tokësore të FSK-së, nga komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama u prit një delegacion i senatorëve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kryesuar nga senatori James M. Inhofe - Kryesues i Komitetit të Senatit për Shërbimet e Armatosura, i cili shoqërohej edhe nga senatorët: Michel B. Enzi; John N. Boozman; Marion Round dhe përfaqësuesit Trent Kelly dhe Gregory Gianforte.

Në takim, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, i njoftoi senatorët për aktivitetet e zhvilluara në kuadër të partneritetin tonë me SHBA-të, rëndësinë që ka për ne ky partneritet dhe në veçanti për Programin e Partneritetit Shtetëror me IOWA-në, bashkëpunimi me Ekipin Ndërlidhës Këshillues të NATO-s (NALT) që është i atashuar në Ministri dhe Forcë si dhe bashkëpunimin e mirë me KFOR-in. Po ashtu gjeneral Rama i njoftoi mysafirët e lartë nga SHBA-të edhe me detyrat dhe planet që e presin FSK-në, me mision të ri-mision ushtarak, në ngritjen e strukturës dhe kapaciteteve operacionale, duke bashkëpunuar ngushtë me SHBA-të, me partnerët tjerë strategjikë, NATO-n dhe vendet aleate.

Kryesuesi i delegacionit të senatorëve nga SHBA-të, senatori James Inhofe ndër të tjera u shpreh se: "Jam i nderuar që udhëheq delegacionin nga Kongresi amerikan në Kosovë. Kosova është një partner i rëndësishëm për Shtetet e Bashkuara dhe për NATO-n, pasi që punojmë së bashku në ndalimin e rritjes së agresionit rus në rajon". Në takim ishin të pranishëm edhe gjeneralmajor Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Enver Cikaqi dhe kolonel Jeton Dreshaj.

# Medalje për oficerët e FSK-së që kryen Akademinë Ushtarake Sandhurst

Në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, para oficerëve të FSK-së të cilët kanë kryer Akademinë Ushtarake Sandhurst në Mbretëri të Bashkuar, u mbajt ligjërata "Qasja në lidership" nga kolonel Roddy Winser, ligjërues i Akademisë Mbretërore Ushtarake Sandhurst. Pas përfundimit të ligjëratës, me një ceremoni rasti u ndanë medalje për të gjithë oficerët e FSK-së, të cilët kanë kryer Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst në Mbretërinë e Bashkuar.

Në ceremoni ishin të pranishëm, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovës, Ruairi O'Connell, koloneli Roddy Wisner, atasheu ushtarak i Mbretërisë së Bashkuar nënkoloneli Andy Layton, gjeneral majori Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Enver Cikaqi, gjeneral brigade Irfete Spahiu, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, gjeneral brigade Xhevahir Geci, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj, gjeneral brigade Naim Haziri, si dhe oficerë dhe nënoficerë të FSK-së.

*Vazhdon në faqe 5,*



# Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha takohet me zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes të Kroacisë

Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, me rastin e shënimit të 11-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, ka marrë pjesë në organizimin e ashtuquajtur "Java e Kosovës në Kroaci". Ndër aktivitetet e organizuara me këtë rast, veç tjerash, ministri Berisha është takuar me zyrtarë të lartë të Ministrisë së Mbrojtës të Kroacisë, me gjeneralë të ushtrisë kroate, si dhe me zyrtarë të tjerë të shtetit mik kroat, me të cilët ka biseduar për thellimin e bashkëpunimit të mëtejmë ndërmjet Ministrisë së Mbrojtës dhe Ushtrisë Kroate me Ministrinë e Mbrojtjes së Kosovës dhe FSK-në.

Gjatë qëndrimit në Kroaci, ministri Berisha, ka zhvilluar një takim të veçantë edhe me ambasadorin e Kanadasë në Republikën e Kroacisë, z. Daniel Maksymiuk, me të cilin ka biseduar rreth zhvillimeve aktuale, bashkëpunimit të mëtejmë ndërmjet dy vendeve mike, dhe njëherësh ministri Berisha e ka njoftuar ambasadorin Maksymiuk me ecurinë e zhvillimeve në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcën e Sigurisë së Kosovës.



## Kosova dhe Franca avancojnë partneritetin për siguri dhe integrimet euro-atlantike



Zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Burim Ramadani pritet nga znj. Geneviève Darrieusecq, sekretare e Shtetit pranë Ministrisë së Armatave, në kryeqytetin e Francës në Paris. Zëvendësministri Ramadani dhe sekretarja e Shtetit, znj. Darrieusecq, gjatë takimit kanë ritheksuar vullnetin dhe gatishmërinë për thellimin dhe avancimin e marrëdhënieve bilaterale midis Kosovës dhe Francës në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Duke vlerësuar bashkëpunimin e deritashëm, ishte konstatim i përbashkët për detajimin e raporteve bilaterale në mënyrë që FSK-ja të avancojë edhe më tutje në profesionalizimin e saj, veçanërisht në fushën e edukimit, sipas standardeve më të larta demokratike.

"Kosova e sheh Francën si partner të rëndësishëm në forcimin e institucioneve tona, si dhe në rrugën tonë për anëtarësim në NATO. Kosova ka qëllim shtetëror integrimet euro-atlantike dhe ne synojmë të jemi vendi i 31-të anëtar i NATO-s", ka theksuar zëvendësministri Ramadani. Ai falënderoi Francën dhe Ministrinë e Armatave për mbështetjen që i kanë dhënë procesit të tranzicionit të FSK-së, si proces gradual dhe transparent. Zëvendësministri Ramadani, gjatë takimit, theksoi përkushtimin e Kosovës për të qenë kontribuuese për sigurinë rajonale dhe globale, duke vlerësuar lart aleancat dhe partneritetin me shtetet e NATO-s.

Sekretarja e Shtetit në Ministrinë franceze të Armatave, znj.Darrieusecq, shprehu gatishmërinë e Francës për të punuar ngushtë me Kosovën me qëllim të ndërtimit të paqes, besimit, stabilitetit dhe perspektivës perëndimore për tërë Ballkanin. Zëvendësministri Ramadani gjatë qëndrimit në Francë do të zhvillojë takime edhe në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Ndërsa, paraprakisht së bashku me ambasadorin e Kosovës në Francë, z. Qëndrim Gashi, ka marrë pjesë në homazhet për të rënët për lirai, në Harkun e Triumfit. Po ashtu, do të merr pjesë edhe në aktivitetet që zhvillon Ambasada e Kosovës në Paris, për nder të 11-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës.

## Takim i përbashkët i zv.ministrave të Mbrojtjes së Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut



Në Tiranë, zëvendësministri i Mbrojtjes z. Burim Ramadani u prit në takim zyrtar nga zëvendësministri i Mbrojtjes së Shqipërisë z. Petro Koçi. Në takim ishte edhe zëvendësministri i Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut z. Bekim Maksuti.

Takimi në Ministrinë shqiptare të Mbrojtjes kishte karakter diskutimi të përbashkët lidhur me përvojat në rajon në rrugën e integrimeve në NATO dhe bashkëpunimin e mëtutjeshëm midis shteteve në çështjet e politikave të sigurisë dhe mbrojtjes. Zëvendësministri Ramadani vlerësoi lart takimin konsultues të këtij formati, duke theksuar dëshirën për zgjerimin e përfaqësimit edhe të shteteve tjera në rajon. „Rajoni ynë dhe shtetet tona kanë nevojë të vazhdueshme për shkëmbimin e përvojave në proceset integruese, si dhe thellimin e bashkëpunimit për të promovuar vlerat perëndimore të rajonit", tha zv. ministri Ramadani. Ai theksoi se Kosova është e përkushtuar në rrugën drejt NATO-s, dhe se anëtarësimi i shteteve të Ballkanit në NATO është alternativa më e mirë për zhvillimin e rajonit të sigurt dhe me prosperitet.

## Ministri Berisha uron ministren Shekerinska për pranimin e Maqedonisë së Veriut në NATO



Ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha ka uruar ministren e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë së Veriut, zonjën Radmila Shekerisnka me rastin e nënshkrimit të protokollit në Bruksel, akt ky që i hapi rrugë fqinjit tonë për anëtarësim në Aleancën Veri-Atlantike. Me këtë rast, ministri Berisha duke uruar ministren Shekerinska dhe nëpërmjet saj edhe të gjithë qytetarët e Maqedonisë së Veriut u shpreh: „ Uroj ministren e Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut, znj. Radmila Shekerinska dhe popullin e Maqedonisë së Veriut për këtë ditë historike, pas një rrugëtimi të gjatë dhe të vështirë".

Aktin e pranimit të Maqedonisë së Veriut në NATO, ministri Berisha e cilësoi si të një rëndësie të veçantë: „Nënshkrimi i protokollit i pranimit të fqinjit tonë, Maqedonisë së Veriut në NATO, është një lajm i rëndësishëm dhe një hap i madh për stabilitetin dhe sigurinë në rajon".

FORCA JONË
Botues: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun, Ministria Mbrojtjes e Republikës së Kosovës
Adresa: MFSK, Kazerma "Adem Jashari", Prishtinë
Adresa elektronike: informimi.mfsk@gmail.com
Tel: 038/551-379
Web: www.mksf-ks.org

## Ministri Rrustem Berisha priti në takim ministrin Rasim Demiri



Ministri i Mbrojtjes, Rrustem Berisha, ka pritur në takim ministrin e Zhvillimit Rajonal z. Rasim Demiri. Ministri Berisha e njoftoi ministrin Demiri për zhvillimet në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Ministri Berisha e falënderoi ministrin Demiri për përkrahjen e vazhdueshme të komunitetit boshnjak të Kosovës për Ministrinë dhe FSK-në. Ministri Berisha në fjalën e tij ndër të tjera tha: "Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, ka dëshmuar në vazhdimësi se është shtëpia e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Ne do të vazhdojmë të ofrojmë mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa dallim etnie apo gjuhe". Ndërkaq, ministri Demiri u shpreh: "Ju falënderoj juve personalisht si ministër dhe Ministrinë që e udhëhiqni, për përkrahjen që keni dhënë për komunitetin boshnjak. Ne jemi shumë të kënaqur me përkushtimin tuaj për të përkrahur komunitetet, andaj edhe përkrahja për ju, nga ana jonë, nuk do të mungojë. Komuniteti boshnjak i Kosovës, do të jetë pjesë e pandashme për zhvillimin e shtetit të pavarur të Kosovës".

## Zv. ministri Ramadani dhe komandanti i FSK-së gjeneral Rama pritën ish-komandantin e FSK-së Sylejman Selimin



Ish-komandanti i UÇK-së, TMK-së dhe FSK-së, gjenerallejtënant Sylejman Selimi, vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, ku është pritur nga zëvendësministri Burim Ramadani dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama. Në pritje morën pjesë edhe sekretari i përgjithshëm z. Shkëlzen Sylaj, gjeneral majori Gëzim Hazrolli, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, Faruk Geci, drejtor i Politikave dhe Planeve etj. Me këtë rast, zv. ministri Ramadani, i ka uruar lirimin nga burgu Sylejman Selimit, duke i dëshiruar shëndet dhe qëndrim të këndshëm në mesin e familjes, shokëve dhe miqve.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjeneral Rama e njoftoi zotin Selimi me të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si dhe tranzicionin e saj në Ushtri të Kosovës dhe të MFSK-së në Ministri të Mbrojtjes. Nga ana e tij, ish-komandanti i FSK-së Sylejman Selimi, e përgëzoi stafin e saj për formimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë së Kosovës.

## Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi mori pjesë në dy ushtrime fushore në Turqi

Me ftesë të komandantit të Forcave Tokësore të ushtrisë turke, nga data 19-22 shkurt 2019, për vizitë në Turqi, ishte komandanti i Forcave Tokësore të FSK-së, gjeneral brigade Enver Cikaqi.

Qëllimi i vizitës ishte pjesëmarrja në DV-day të dy ushtrive fushore që u realizuan në Turqi, gjatë muajit shkurt. Më datë 20 shkurt, gjeneral Cikaqi mori pjesë në DV- day të ushtrimit vendkomandë „Cooperative Resolve 2019", ushtrim që u realizua në Qendrën e Trajnimit dhe Edukimit në Ankara. Gjatë vizitës në këtë qendër, gjenerali u prit nga komandanti i Forcave Tokësore të ushtrisë turke gjenerali Umit Dundar, i cili shprehu gatishmërinë e ushtrisë turke për rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Forcave Tokësore të dy ushtrive. Megjithëse Forca e Sigurisë së Kosovës nuk ishte e angazhuar në këtë ushtrim, me anë të kësaj vizite, gjeneral Cikaqi pati rastin që nga afër t'i shihte angazhimet e shteteve



të tjera pjesëmarrëse dhe qëllimin e trajnimit. Andaj, angazhimi i pjesëtarëve të FSK-së, në kuadër të këtij ushtrimi në vitet e ardhshme do t'i kontribuonte përmirësimit të trajnimit, bashkëpunimit dhe ndërveprimit të FSK-së, në raport me shtetet e rajonit.

Në po të njëjtën datë, gjeneral Cikaqi u prit në darkë zyrtare nga gjenerali Dundar, ku ishin të pranishëm edhe gjeneralë të tjerë dhe shefa të ushtrive të rajonit dhe më gjerë. Më datë 21 shkurt 2019 gjeneral Cikaqi mori pjesë në realizimin e demonstrimeve të ushtrimit "Dimri", ku në mesin e shumë shteteve pjesëmarrëse ishin edhe shtatë pjesëtarë të FSK-së. Realizimi i suksesshëm i ushtrimit "Dimri" demonstroi përgatitje shumë të mëdha dhe të koordinuara deri në detaje në realizimin e skenarëve të operacioneve ofensivë.

Qëllimi i këtij ushtrimi ishte testimi i kapaciteteve luftuese të njësive dhe përmirësimi i sinkronizimit të zjarrit dhe manovrimit në kushte dimri. Në këtë ushtrim morën pjesë rreth 1750 pjesëtarë nga 15 shtete të rajonit, duke përfshirë Kosovën, Mbretërinë e Bashkuar, Gjermaninë, Gjeorgjinë, Azerbajxhanin, Bangladeshin, Bosnjën dhe Hercegovinën, Bullgarinë e të tjera. Pjesëtarët e Forcës së Sigurisë të Kosovës përfituan nga përvoja e madhe e ushtrisë turke në organizimin e ushtrimeve të tilla me karakter ndërkombëtar, dhe këto njohuri do të ndihmojnë në përmirësimin e qasjes tonë në organizimin e ushtrimeve fushore në FSK. Po ashtu më 21 shkurt 2019, me ftesë të Ambasadës së Kosovës në Turqi, gjeneral Cikaqi mori pjesë në pritjen e organizuar me rastin e shënimit të 11- vjetorit të Pavarësisë, ku pjesëmarrës ishin diplomatë nga shumë vende të rajonit. Gjatë pritjes gjeneral Cikaqi takoi të gjithë kadetët dhe ushtarakët e FSK-së, që po realizojnë studimet në Turqi, të cilët i uroi për rezultatet e arritura dhe u kërkoi që të vazhdojnë të jenë të disiplinuar, të angazhuar dhe të përfaqësojnë Kosovën me dinjitet në akademitë ku po studiojnë. Gjeneral Cikaqi, gjatë vizitave u shoqërua nga atasheu ushtarak i FSK-së në Turqi, koloneli Bekim Osmani.

## Ministri Rrustem Berisha priti deputetët e Grupit Parlamentar 6 Plus

Ministri i Mbrojtjes, z. Rrustem Berisha, ka pritur në takime të ndara deputetët e Kuvendit të Kosovës, Albert Kinolli dhe Danush Ademi dhe deputetet Myfera Shinik dhe Fikrim Damka nga Grupi Parlamentar 6 Plus. Ministri Berisha falënderoi deputetët për përkrahjen e tyre të jashtëzakonshme në të gjitha proceset që ka kaluar Kosova e veçanërisht për përkrahjen e pakursyer për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe Ministrinë e Mbrojtjes.

"Deklaratat, aktivitetet tuaja dhe angazhimi juaj në Kuvend, na kanë bërë të ndihemi jashtëzakonisht mirë, sidomos, pasi kjo përkrahje ka ardhur nga ju, si përfaqësues të komuniteteve pakicë të Kosovës. Kjo tregon besimin që ka Ushtria jonë tek qytetarët e vendit, tek të gjitha komunitetet"- tha ministri i Mbrojtjes, z. Berisha.

Ministri Berisha, më tej tha, se "Tani kemi detyrë të punojmë sa më shumë për ngritjen e kapaciteteve të ushtrisë sipas dinamikës së paraparë me planin e tranzicionit". Deputetët e komunitetit ashkali dhe romë, z. Kinolli dhe Ademi, pasi uruan ministrin Berisha për Ushtrinë dhe Ministrinë e Mbrojtjes, u zotuan se do të vazhdojnë ta mbështesin çdo nismë në të mirë të të gjithë qytetarëve dhe në të mirë të Kosovës.

Gjithashtu edhe deputetët e komunitetit turk, Shinik dhe Damka, pasi uruan ministrin Berisha për Ushtrinë dhe Ministrinë e Mbrojtjes, u zotuan se do të vazhdojnë të mbështesin çdo nismë në të mirë të qytetarëve të Kosovës. "Ne si komunitet, jemi shumë të gëzuar që tani kemi ushtrinë tonë, do të vazhdojmë të mbështesim gjithçka që vjen në Kuvend, dhe me mundësitë tona, e që është për të mirën e vendit tonë. Djemtë dhe vajzat e komunitetit tonë janë të gatshëm dhe shumë të interesuar t'i bashkëngjitën ushtrisë", theksuan ata.

### FOTOLAJM

### Zv.ministri Ramadani dhe ambasadori Gashi homazhe te varri i ushtarit të panjohur në Paris



# FSK-ja parakaloi në përvjetorin e 11-të

Në përvjetorin e 11-të të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, në sheshin „Skënderbeu" parakaluan kuadratet e Ushtrisë së Kosovës para udhëheqësve shtetërorë dhe mijëra qytetarëve. Ceremonia solemne e manifestimit filloi me intonimin e himnit të Kosovës nga Orkestra frymore e Forcës së Sigurisë të Kosovës. Në manifestimin qendror që u mbajt me këtë rast ishin të pranishëm udhëheqësit shtetërorë të Kosovës; presidenti Hashim Thaçi, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj, kryeministri i Republikës Shqipërisë Edi Rama, ambasadori i SHBA-ve, Filip Kosnnet, vëllai i komandanti legjendar Adem Jashari, Rifat Jashari, ministra dhe mysafirë të shumtë, ambasadorë, diplomatë, përfaqësues të KFOR-it, si dhe mijëra qytetarë të Kosovës dhe trojeve etnike. Po ashtu ishin të pranishëm edhe ministri i Mbrojtjes Rrustem Berisha, komandanti i FSK-së gjenerallejtënant Rrahman Rama, zyrtarë të lartë të ministrisë, gjeneralë dhe oficerë të FSK-së.

Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, gjatë fjalimit të tij, në përvjetorin e 11-të të Pavarësisë, pos tjerash tha se FSK-ja është krenaria e Kosovës.

„Para nesh kemi një ushtri profesionale, e cila është në shërbim dhe mbrojtje të shtetit më të ri në Evropë, e gatshme për të kontribuar për paqe në rajon dhe botë. Vendimi për themelimin e ushtrisë ishte i drejtë, legjitim dhe mesazh historik" tha pos tjerash presidenti Thaçi.

Pas fjalës së presidentit, komandanti i parakalimit, gjeneral brigade Enver Cikaqi, raportoi para presidentit Hashim Thaçi, për gatishmërinë e kuadrateve të Forcës së Sigurisë së Kosovës për parakalim. Kuadratet e FSK-së parakaluan duke filluar nga Togu Ceremonial, Batalioni i Parë i BRSH-së, Batalioni i Dytë i BRSH-së dhe Batalioni i Tretë i BRSH-së, Brigada e Mbështetjes Operacionale, Regjimenti i Mbrojtjes Civile, Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, Qendra për Studime Universitare dhe Orkestra Frymore e FSK-së. Kuadratet e FSK-së, gjatë parakalimit u shoqëruan me brohoritje dhe duartrokitje nga qytetarët e pranishëm në sheshin Skënderbeu.








## Ministri i Mbrojtjes dhe komandanti i FSK-së homazhe në Kompleksin Memorial në Prekaz

Me rastin 11- vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës, ministri Rrustem Berisha dhe komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, në kuadër të delegacionit shtetëror, bënë homazhe te varri i komandanti legjendar Adem Jashari, në Kompleksin Memorial në Prekaz.

Po ashtu, ministri Berisha dhe komandant Rama, bënë nderime edhe tek shtatorja e ish-presidentit Ibrahim Rugova. Po ashtu, me rastin e ditës së Shpalljes së Pavarësisë, delegacion i lartë i Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, bënë homazhe dhe vendosen lule të freskëta te varri i komandantit legjendar Adem Jashari në Kompleksin Memorial në Prekaz.



# të Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës




## Medalje për oficerët e FSK-së që kryen Akademinë Ushtarake Sandhurst

*Vijon nga faqja parë,*

Me këtë rast, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, pasi përshëndeti të pranishmit, i përgëzoi oficerët e FSK-së për arritjet e tyre gjatë studimeve në Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst. Ai pos tjerash, tha: „Padyshim që synojmë të rrisim bashkëpunimin me Mbretërinë e Bashkuar, në mënyrë që t'u përgjigjemi nevojave tona në kuadër të zhvillimit të forcës, por edhe të shprehim gatishmërinë që të ofrojmë kapacitetet tona, duke kontribuar kështu në ruajtjen e paqes kudo në botë. Si rezultat i bashkëpunimit të ndërsjellë, FSK-ja për herë të parë do të dërgojë një oficer të saj, në detyrën e instruktorit të kësaj akademie të respektuar. Andaj, shfrytëzoj këtë rast që të falënderoj Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst, për mundësinë që edhe ne të kontribuojmë në zhvillimin e liderëve të rijnë".

Ndërsa ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Kosovës, Ruairi O'Connell, ndër të tjera tha: "Kosova është vendi më i ri në pertneritet me vendin tonë, prandaj ndikimi i secilit oficer çdo ditë është i matshëm. Është krenari për vendin tim sepse që nga fillimi kemi qenë me ju dhe po vazhdojmë ta mbështesim Forcën tuaj, duke bartur përvojat tona te ju. Kosova duhet t'i përdorë këto përvoja, varësisht nga nevojat që kanë oficerët tuaj t'i përdorin përvojat e fituara, në mënyrë që të japin kontributin e vet dhe të shkruajnë kapitullin e tyre në historinë e Kosovës". Në fund oficerëve të FSK-së, të cilët kanë kryer Akademinë Ushtarake Mbretërore Sandhurst, për suksesin e treguar ju ndanë medalje nga gjeneral Rama, ambasadori O'Connell, atasheu ushtarak nënkolonel Layton dhe koloneli Winser.





# Zëvendëskomandanti i KFOR-it gjenerali Reinhard Ruckenstuhl vizitoi Brigadën e Reagimit të Shpejtë në Istog



Në kazermën „Ushtarët e NATO-s“ të Brigadës për Reagim të Shpejtë në Istog, qëndroi për vizitë pune, zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Reinhard Ruckenstuhl, i cili shoqërohej nga komandanti i Forcave Tokësore, gjeneral brigade Enver Cikaqi. Ata u pritën nga komandanti i Brigadës së Reagimit të Shpejtë, gjeneral brigade Fadil Hadërgjonaj.

Me këtë rast, zv. komandanti i KFOR-it, gjeneral Ruckenstuhl u njoftua me përbërjen dhe nivelin operacional të BRSH-së, aktivitetet e zhvilluara, bashkëpunimin me KFOR-in dhe NALT-in, ndihmën e ofruar në trajnime dhe ushtrime të përbashkëta dhe vazhdimin e bashkëpunimit të afërt ndërmjet KFOR-it , FSK-së dhe BRSH-së.

Gjithashtu u bisedua edhe për stërvitjet dhe operacionet e përbashkëta, tani kur veç ka filluar edhe faza e planifikimit të ushtrimit ndërinstitucional „Silver Sabre 2019” që organizohet nga KFOR-i, ku marrin pjesë të gjitha institucionet e Sigurisë që veprojnë në Kosovë. Pas takimit, zv. komandanti i KFOR-it, gjenerali Ruckenstuhl dhe gjeneral Cikaqi vizituan ambientet e kazermës „Ushtarët e NATO-s“ dhe u informuan për aktivitetet e kësaj brigade, të cilat janë rutinë dhe zhvillohen sipas planifikimit. Gjenerali Reinhard Ruckenstuhl u shpreh shumë i impresionuar me nivelin e profesionalizmit dhe aplikimit të procedurave bashkëkohore të realizimit të detyrave të BRSH-së.

# Kolonel Isufi diplomon në Institutin Shumëkombësh të Udhëheqjes Strategjike në Stamboll



Koloneli Sefer Isufi ka diplomuar në Universitetin e Mbrojtjes në Stamboll, gjegjësisht në Institutin Shumëkombësh të Udhëheqjes Strategjike të Forcave të Përbashkëta, në degën e Komandimit dhe Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura në Operacione të Përbashkëta. Në ceremoninë e diplomimit morën pjesë përfaqësuesit e lartë institucionalë dhe ushtarakë si dhe përfaqësues institucionalë dhe ushtarakë nga vendet pjesëmarrëse në institutin përkatës.

Në ceremoni ishte edhe atasheu i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës koloneli Bekim Osmani, cili u prit nga Rektori i Universitetit të Mbrojtjes, prof. dr. Erhan Afyoncu. Kolonel Osmani në emër të ministrit të Mbrojtjes dhe komandantit të FSK-së, përcolli falënderimet e tyre për shkollimin e oficerëve dhe nënoficerëve të FSK-së, në të gjitha nivelet që ofron Universiteti i Mbrojtjes Kombëtare i Turqisë. Kolonel Seferi tregon se plan-programi studimor, ka përfshirë në mënyrë kronologjike modulet rreth sigurisë globale, rajonale dhe nacionale, ndërlidhjen e tyre me strategjitë nacionale të mbrojtjes dhe ushtarake, si dhe procesin e implementimit të tyre në operacione të mundshme të të gjitha komponentëve të forcave (joint) nga niveli i komandimit dhe drejtimit strategjik ushtarak.

Pasi kreu shkollimin për udhëheqje shtabore dhe komanduese në nivelin taktik dhe operacional ushtarak dhe pasi mbrojti temën e masterit në artin e menaxhimit strategjik të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, këto ditë, në të njëjtin universitet, diplomoi me sukses të lartë në nivelin e vlerësimit „Ekselent“. Ai u dallua në mesin e pjesëmarrësve të rreth 20 ushtrive të vendeve nga tri kontinente.

# FSK-ja mban ligjërata në shkollat fillore për vetëdijesimin e nxënësve ndaj mjeteve të pashpërthyera

Në disa nga shkollat fillore të komunave Prishtinë, Klinë dhe Malishevë, instruktorët e Kompanisë së Deminimit të FSK-së, edhe këtë vit, që nga 20 shkurti i vitit 2019, kanë filluar mbajtjen e ligjëratave për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i mjeteve të pashpërthyera.

Këto ligjërata po realizohen në bazë të planit të Departamentit për Bashkëpunim Civilo-Ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes me drejtoritë e arsimit të të gjitha komunave të Republikës së Kosovës. Ligjëratat e para për këtë vit u realizuan në shkollën fillore “Tre Dëshmorët” në fshatin Jashanicë e Ulët dhe në paralelen e saj të ndarë në Jashanicë të Lartë, në Komunën e Klinës. Gjatë këtyre ligjëratave, interesimi i nxënësve ishte i madh për t’u pajisur me njohuri rreth mjeteve të pashpërthyera dhe rreziqeve të mundshme nga to, si dhe përdorimin e procedurave standarde në rastet kur i hasin ato. Instruktorët e deminimit aktivitetin për vetëdijesimin e nxënësve nga rreziku i mjeteve të pashpërthyera do ta vazhdojnë nëpër shkollat e Republikës së Kosovës deri më 4 mars 2019.



# Ushtria e Kosovës merr pjesë në stërvitjet dimërore në Turqi

Në qytetin Kars të Turqisë, ka filluar ushtrimi fushor ndërkombëtar „WINTER EXERCISE 19“ (Ushtrimi dimëror) në të cilin po marrin pjesë përfaqësues nga 13 shtete. „Ushtrimi dimëror 19“ ka për qëllim testimin e kapaciteteve luftarake në kushte të dimrit (borë me trashësi deri 50 cm dhe temperatura deri -20 gradë celsius), si dhe forcimin e ndërveprimit në mjedise të përbashkëta operacionale.



FSK-ja po merr pjesë me një kontingjent prej shtatë pjesëtarësh të rangut; oficerë dhe nënoficerë-stafi. Kontingjenti i FSK-së, ka zbarkuar më datën 06 shkurt 2019 dhe i është bashkuar Brigadës së 14-të të Mekanizuar të Ushtrisë Turke, në detyra të ndryshme, si oficerë/nënoficerë stafi, etj.

Komandanti i Kontingjentit të FSK-së, majori Albert Kuqi, deklaroi se; „Të gjithë oficerët dhe nënoficerët e FSK-së, janë në nivel të detyrës duke treguar profesionalizëm gjatë realizimit të këtij ushtrimi të përbashkët operacional. Qëllimi i pjesëmarrjes së FSK-së, është që pjesëtarët tanë të trajnohen dhe zhvillojnë shkathtësitë e planifikimit dhe ekzekutimit të ushtrimeve, ku përfshinë; qitje reale nga armët e kombinuara të kalibrave të ndryshme në një operacion konvencional ushtarak, si dhe këto përvoja t'i aplikojmë në vendin tonë në kushte dhe ambiente të ngjashme“, shtoi major Kuqi. Ushtrimi „WINTER EXERCISE 19“ do të përfundojë më 22 shkurt 2019.

# Operacion i përbashkët i ekspertëve amerikanë dhe të FSK-së për demolimin e mjeteve të pashpërthyera



Specialistët e Ekipeve për Eliminimin e Mjeteve të Pashpërthyera Eksplozive(EOD) të Kompanisë së Deminimit të Forcës së Sigurisë të Kosovës, në bashkëpunim me specialistët e Ekipit të EOD-së, nga kampi amerikan „Bondsteel", kanë realizuar një operacion të përbashkët për shkatërrimin e mjeteve eksplozive, të cilat janë gjetur nga ekipet e EOD-së në rajone të ndryshme të Kosovës.

Në këtë operacion janë demoluar 16 mjete të kalibrave të ndryshëm, të cilat kanë qenë rrezik permanent për jetën e qytetarëve. Demolimet janë realizuar në fshatin Halilaq, të organizuar në dy cikle. Operacioni i demolimit ka shkuar sipas planifikimit dhe është realizuar me sukses. Për të përcjellë nga afër këtë operacion, prezent ishte edhe komandanti i kampit „Bondsteel", koloneli Macaraeg, koordinatori për Deminim nga „Film City, A. Cipri, zëvendëskomandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile (RMC), nënkolonel Bajram Bekteshi, si dhe komandanti i Kompanisë së Deminimit, major Gëzim Sada. Të pranishmit u ndan të kënaqur me punën dhe angazhimin e ekspertëve të EOD-së dhe vlerësuan lart bashkëpunimin e ndërsjellë të FSK-së me KFOR-in.



# Interesim i madh i të rinjve për shërbim aktiv në Forcën e Sigurisë së Kosovës



Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës, më datë 11-22 shkurt 2019, ka shpallë zyrtarisht konkursin publik për rekrutimin e rekrutëve (OR1) - ushtarëve që do të shërbejnë në komponentin aktiv të Forcës së Sigurisë të Kosovës. Konkursi u shpall mbi bazën e Planit të Veprimit 2019 të Ministrisë së Mbrojtjes. Bazuar në këtë plan, po zhvillohet edhe procesi i shqyrtimit, filtrimit dhe përzgjedhjes së rekrutëve të rinj që do të pranohen në FSK. Kriteret e përgjithshme për rekrut/OR1(ushtar) të FSK-së do të jenë:

Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës; të ketë të përfunduar shkollën e mesme; të jetë i moshës 18-23 vjeç; të ketë zotësi të plotë për të vepruar; të zotërojë aftësitë e nevojshme shëndetësore e fizike për vendin e shërbimit si dhe të mos jetë i dënuar për vepër penale, me vendim të formës së prerë. Procedurat e shqyrtimit, filtrimit dhe përzgjedhjes do të jenë: Shqyrtimi fillestar i aplikacioneve; testi i aftësive; testi fizik; intervista me shkrim dhe me gojë; testi mjekësor; trajnimi; verifikimi; emërimi si dhe e drejta e ankesës. Dokumentet e kërkuara për aplikim sipas konkursit janë: Diploma (dëshmi) e shkollimeve të përfunduara; dëshmi; certifikata; mirënjohje (nëse posedon); certifikata e lindjes (jo me e vjetër se 6 muaj); certifikata e shtetësisë; vërtetimi nga gjykata që nuk është nën hetime apo i ndjekur penalisht; kopje e letërnjoftimit apo pasaportës si dhe dy fotografi të formatit (5 cm x 5 cm). Shtetasit e Republikës së Kosovës të cilët konkurrojnë mund të pranohen në Forcën e Sigurisë së Kosovës pasi të kenë plotësuar kërkesat dhe kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes.

Pranimi në FSK konfirmohet pas përfundimit të trajnimit bazik dhe gjatë kësaj kohe kandidatët do të cilësohen si rekrutë (OR1). Pas përfundimit të trajnimit bazik rekrutët marrin gradën e ushtarit. Interesimi i të rinjve për ta mveshur uniformën e FSK-së, ishte shumë i madh flet vet fakti se gjatë 11 ditëve kanë aplikuar mbi 6759 veta, prej tyre 451 janë femra dhe 174 pjesëtarë të komuniteteve.

# Certifikohen kursantët e kursit bazik “Mbijetesa në Dimër”



Në Qendrën Trajnuese për Kërkim-Shpëtim, dje u mbajt ceremonia e certifikimit për pjesëtarët e FSK-së, të cilët përfunduan me sukses kursin “Mbijetesa në Dimër/ Mot të Ftohtë’ në terren të hapur. Pjesëmarrësit në kursin dimëror përfaqësonin të gjitha njësitet e FSK-së, përfshirë: BRSH-në, PF-në, TFKSH-në dhe Kompaninë e Deminimit.

Qëllimi i mbajtjes së kursit, me intensitet të lartë, ishte përshtatja dhe mbijetesa në kushte ekstreme të motit. Gjithashtu gjatë trajnimit pjesëmarrësit janë mësuar me ndërtimin e strehimoreve për mbijetesë me materialin e gjendur në natyrë, metodat e ndezjes së zjarrit dhe sigurimin e ujit dhe të ushqimit. Pjesëmarrësit e trajnimit janë përgatitur edhe për orientimin në natyrë, pa harta dhe busulle, vetëm duke u orientuar përmes diellit, hënës, yjeve dhe objekteve të tjera në natyrë. Finalizimi i kursit ishte marshimi i pjesëmarrësve në kushte ekstreme të ftohta, në gjatësi mbi 8 km, ku ata kaluan 36 orë, jashtë, në natyrë, duke praktikuar mësimet e mësuara.

Në ceremoninë e certifikimit ishte i pranishëm edhe komandanti i Regjimentit të Mbrojtjes Civile, koloneli Shaip Haziri, i cili uroi pjesëmarrësit për përfundimin me sukses të këtij kursi shumë të vështirë. Kurse, drejtori i QTKSH-së, Joni, i uroi pjesëmarrësit për disiplinën dhe përkushtimin e treguar gjatë trajnimit. Pjesëtarët e FSK-së, të cilët arritën ta përfundojnë me sukses trajnimin, tani janë të gatshëm që po ashtu me suksesi t’i bartin njohuritë e fituara te njësitet dhe kolegët e tyre.

Të gjithë pjesëmarrësit e trajnimit kanë arritur t’i plotësojnë kriteret e kursit, dhe janë certifikuar për Nivelin e Avancuar të Kursit “Mbijetesa në kushte të vështira dimri”.

# FSK-ja shkatërron ortekët e borës në Brezovicë

Në një lartësi mbidetare mbi 2230 metra dhe mot të keq, ekipet e Kërkim-Shpëtimit dhe të Deminimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, kanë realizuar me sukses misionin e tyre për largimin e ortekëve të borës. Ishte mision i vështirë, por i realizueshëm për ekipet profesionale të FSK-së. Këta ortekë për fat të keq, para ca ditësh morën edhe jetë njerëzish.



Pas vlerësimit të situatës nga ekipet e Kërkim-Shpëtimit të FSK-së, ekipet e Deminimit, me gjithë kushtet e vështira, kanë filluar punën më datë 02.02.2019 për largimin e ortekëve të rrezikshëm të borës në kompleksin turistik në Brezovicë. Së pari shkatëruan ortekun e parë me eksploziv, i cili paraqiste rrezik të madh për krijimin e një orteku edhe më të madh dhe shumë të rrezikshëm për qytetarët. Për shkak të motit shumë të vështirë dhe erërave të forta, deri në 60km/h, operacioni është dashur të ndërpritet. Operacioni ka vazhduar më datën 04.02.2019, me ç ‘rast është larguar edhe orteku i dytë.

Sipas vlerësimeve për momentin nuk ka rrezik potencial për lëvizje të ortekëve, mirëpo duke u bazuar në kushtet atmosferike të cilat mbretërojnë në këtë pjesë mund të krijohen ortekë të cilët mund të paraqesin rrezik për jetën e qytetarëve. Vështirësitë në terren kanë qenë shumë të mëdha, por falë përgatitjes profesionale të ekipeve të FSK-së, dhe falë vullnetit të madh, për të mos lejuar të ndodhë ndonjë katastrofë natyrore për vizitorët në këto pjesë, është arritur që operacioni i ekipeve të Deminimit të kryhet me sukses.



# Zhytësit e FSK-së nxjerrin trupin e pajetë të qytetarit E.Sh. nga liqeni i Livoqit



Një skuadra e Kërkim-Shpëtimit në Ujëra e Forcës së Sigurisë të Kosovës, me vendim të ministrit të Mbrojtjes, z. Rrustem Berisha, dhe me urdhër të komandantit të Ushtrisë, gjenerallejtënant Rrahman Rama, më datë 02 shkurt 2019 (e shtunë), angazhohen që nga ora 22:03, në vlerësimin e gjendjes në liqenin e Livoqit ( komuna e Gjilanit), pas njoftimit nga Policia e shtetit për dyshimin se aty, kishte rënë një person me inicialet E.Sh. nga Gjilani.

Pas vlerësimit të gjendjes dhe planifikimit të detajuar, operacioni i kërkimit nga zhytësit e FSK-së, ka filluar më datë 03.02.2019, në ora 09:00, të cilët pas një pune vetëmohuese, duke u përballur edhe me kushtet e vështira atmosferike të shkaktuara nga ngricat dhe akulli mbi liqen, por edhe falë profesionalizmit të tyre, arritën që të identifikojnë lokacionin, dhe të nxjerrin në breg trupin e personit të shpallur në kërkim. Trupi i pajetë i personit E.Sh. i është dorëzuar Policisë së Kosovës dhe ekipeve të Mjekësisë Ligjore për procedura të mëtejshme.

Siç na njoftoi kapteri Naim Mala, ekipet e FSK-së, pas operacionit të suksesshëm janë kthyer në repartet e Kazermës së Regjimentit të Mbrojtjes Civile të FSK në Pomozotin.

# “Mitet” dhe personazhet historike të vrasësit në Zelandën e Re

Terroristi Brenton Tarrant tha se admironte udhëheqësit e mëdhenj dhe gjeneralët e kaluar që ishin protagonistë të betejave epokale kundër pushtuesve, në shumicën e rasteve osmanët dhe myslimanët




Nga Carlo Martello te Sebastiano Venier, duke kaluar nëpër Marcantonio Bragadin dhe Marcantonio Colonna: ata janë protagonistët e mëdhenj të historisë së nderuar nga Brenton Tarrant, terrorist i cili kreu një masakër në dy xhami në Christchurch të Zelandës së Re. Vrasësi i quajti ata “heronj” për vendosmërinë e tyre vendimtare në betejat kundër osmanëve, muslimanëve dhe, në përgjithësi, kundër pushtuesve. Tarrant gjithashtu citoi presidentin amerikan Donald Trump dhe Anders Breivik, “përbindëshin e Oslos”, i cili vrau 77 njerëz në Norvegji në vitin 2011.

**Carlo Martello** – Le të fillojmë me protagonistin “më të largët” në kohë: Carlo Martello. Një emër që ngjall menjëherë rezistencën e madhe dhe fitimtare të Europës së krishterë në avancimin e pushtuesve muslimanë të Spanjës së sotme. Referenca më e famshme është padyshim ajo e Betejës së Poitiers të vitit 732, në të cilën Franksët arritën të sprapsin ushtrinë arab-berbere muslimane të Al-Andalusit, të cilat përndryshe do të kishin shpërthyer në Francë-Gali. Megjithatë, dy elementë historikë kanë disi “të holluar” mitin e Carlo Martellos. Para së gjithash, përtej traditës popullore, në kohën e betejës nuk ishte mbreti i Franks, por “vetëm” butler i Pallatit të dinastisë Merovingiane: një lloj sunduesi i mbretit, i barabartë me shefin ekzekutiv dhe ushtrinë . Beteja e Poitiers, për më tepër, kishte një rezultat shumë më modest nga ai që iu dha imagjinatës kolektive nga legjenda: kërcënimi mysliman nuk ishte ndalur në fakt, aq shumë saqë një dekadë më vonë (në 744) arabët pushtuan qytetet provansale e Avignonit dhe Arles. Sidoqoftë, duhet të thuhet se, nga pikëpamja strategjike, fitorja ishte vendimtare në masën që i lejoi Carlo Martellos të vendoste bazat e para të një të ardhme ambicioze perandorake për veten dhe familjen e tij, e cila pastaj do të përfundonte nga nipi Carlo Magno.

**Marcantonio I Colonna** – “Miti” i dytë i Tarrantit në rend kronologjik është Marcantonio I Colonna, udhëheqës i njohur italian aktiv në fillim të shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Pasi u angazhua si një “mbrojtës” nga Republika e Firences dhe u martua me mbesën e Papës Julius II, ai shkoi për të shërbyer për herë të parë në Republikën e Venecias dhe më vonë Mbretin e Francës. Arritja e tij më e madhe është që ka udhëhequr Lidhjen e Shenjtë në betejën e Ravenës (1512), një betejë e madhe në të ashtuquajturën Luftën Italiane, e cila përfundoi me fitoren e francezëve. Në 1522 ai organizoi mbrojtjen e Milanos, por gjatë inspektimit të linjave të para ai u godit nga një goditje nga kolubrina dhe u plagos rëndë.

**Marcantonio Bragadin** – Është rradha e gjeneralit Marcantonio Bragadin, rektor i qytetit të fortesës në Famagosta në ishullin e Qipros, gjatë rrethimit të osmanëve zgjati nga 22 gushti 1570 deri më 4 gusht 1571. Gjithashtu në këtë rast, pra, është një figurë udhëheqëse e kundërshtimit të krishterë ndaj pushtimit turko-osman. Rezistenca e të rrethuarit shkoi përtej çdo parashikimi optimist, duke pasur parasysh pabarazinë e forcave në terren dhe mungesën e ndihmës nga vendi amë. Në korrik 1571 ushtria osmane arriti të shkelë muret e qytetit, por u zmbraps me kosto të madhe. Kur përfundoi ushqimi dhe municioni, më 1 gusht Bragadini u detyrua të deklaronte dorëzimin.

**Sebastiano Venier** – Viti i veprimit është i njëjtë në të cilin gjenerali Bragadin ishte protagonist: 1571, viti i Betejës së famshme të Lepanto. Sebastiano Venier, i cili më vonë u bë Doge i Republikës së Venedikut, ishte një aktor i madh i përplasjes që pa forcat e Lidhjes së Shenjtë t’u shkaktojnë një humbje të rëndësishme turqve. Vlera e tij është ndoshta e barabartë vetëm me disa nga zakonet e saj “ekstravagante”. Pavarësisht se ishte 75 vjeç në atë kohë, Venier mori pjesë në luftën, duke vrarë turq të shumtë me hark që një ndihmës rimbushej, sepse sipas disa kronikave krahët e tij nuk kishin forcë të mjaftueshme. Ai u plagos gjithashtu në këmbë nga një shigjetë që, siç thuhet, u gris. Kreu i ardhshëm i Serenissima përdoret gjithashtu për të veshur pantofla në vend të çizmeve, sepse sipas mendimit të tij ata bënë kapje më të mirë në kuvertën e lagësht të anijes. Sidoqoftë, duket se motivimi i vërtetë është fakti që ai vuan nga kalluse ose përdhes.

















**Anders Breivik** – Sigurisht që ai nuk është një personazh historik, sikurse të tjerët të përmendur, por është edhe Anders Breivik në listën e “heronjve” që frymëzuan terroristin e Christchurch. Ky i fundit shpjegoi në “manifestin” e tij të botuar në Net që ai gjithashtu kontaktoi me autorin e masakrës së Utojës. Duke kujtuar se ndër inspiruesit e tjerë të masakrës përfshihen “Luca Traini, Dylan Roof, Anton Lundin Pettersson, Darren Osbourne”, Tarrant më pas shpjegoi se ai kishte kontaktuar “vëllezërit e kalorësve” të Breivik duke marrë bekimin e tyre për “misionin” vdekja.

**Skënderbeu** – Një ndër këta emra dallohet të jetë edhe “Skanderbeg”, i cili besohet se i referohet heroit tonë kombëtar, i cili shërbeu si barrierë për vite të tëra në frenimin e osmanëve në Evropë.

**Milos Obiliq,** serbi i cili vrau sulltan Muratin I në fund të Luftës së Kosovës më 1389. Terroristi kishte shkruar emrin e Obilicit në armë me shkronja cirilike.

**Ernst Rudiger von Starhemberg,** një komandant ushtarak i Vjenës i cili luftoi kundër trupave osmane në rrethimin e dytë të Vjenës.

**Feliks Kazimiers Potocki,** një ushtar polak i cili gjithashtu luftoi kundër turqve osmanë në rrethimin e Vjenës.

**Charles Martel,** një burrë shteti francez dhe udhëheqës ushtarak i cili ndaloi kalifatin islamik nga pushtimi i një pjese të rëndësishme të Evropës, duke e detyruar atë të kthehej në Spanjë në vitin 732.

**Josue Estebanez,** një neo-nazist spanjoll i cili u bë ‘hero’ për neonazistët për vrasjen e aktivistit të majtë 16-vjeçar Carlos Palomino, duke e goditur atë në Madrid në vitin 2007.

**Alexandre Bissonnette,** një supremacist i bardhë, i cili gjithashtu sulmoi një xhami në Kanada dhe vrau gjashtë adhurues në janar 2017.

**Anton Lundin Pettersson,** i cili vrau dy studentë emigrantë në tetor 2015, në Suedi.

**Gazeta Shqip**

E rrallë

## Në aeroportet franceze makinat parkohen nga robotët



Pas disa vjetësh testime, Stanley Robotics zyrtarisht vendosi flotën e robotëve në punë këtë javë në Aeroportin Saint Ekzyperi të Lionit. Të gjithë ata që parkojnë makinat në hapësirën e robotëve duhet t'i lënë në një kuti speciale në formë garazhi. Një prej robotëve të Stanley do ta marrë makinën dhe ta dërgojë te vendi i parkimit.

FOTO E DITES



Një pamje ajrore tregon pamjen e kodrave në Californi të ShBA-së. Fotografia është publikuar te 'The Guardian'.

E jashtëzakonshme

## Një restorant nën ujë, ku darka kushton sa një rrogë mujore



Në Norvegji është hapur restoranti i parë nënujor në Evropë. Pamja e ofruar është spektakolare, pasi teksa je duke drekuar panorama e ofruar është mbresëlënëse, por kjo e ka një kosto. E për një shqiptar që jeton në Shqipëri është sa rroga e një muaji, pasi një darkë me peshqit mund të kushtojnë deri në 325 paund për person.

BARSOLETA E DITËS



**Vajza: Nuk ndihem mirë sot.**
**Djali: Sa keq! Sa desha të të thosha të dilnim të blinim rroba.**
**Vajza: Bëra shaka, se mirë jam.**
**Djali: Edhe unë bëra shaka.**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 16:00

### "THE GRINCH" 3D,




I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney



Në ora 17:30

### "THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

### "MORTAL ENGINES" 3D,




Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers




Në ora 22:00

### "HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI** Mundohuni të vepronimë shumë sesa të mendoni sot. Nuk duhet të tërhiqeni nëse shikoni që situata tensionohet jo për shkakun tuaj.



**DEMI** E vlerësoni shumë sinqeritetin në marrëdhënie, kështu që, edhe pse dikujt mund t'i dukeni shumë i drejtpërdrejtë, sot është vetëm për këtë arsye.



**BINJAKËT** Shoqëria e miqve tuaj sot do t'ju sjellë në humor dhe do të bëjë të harroni disa tensione në punë. Edhe takimet me njerëz të rinj sot do t'ju ndihmojnë.



**GAFORRJA** Sot nuk ndiheni mjaft mirë nga gjendja shpirtërore. Çdo gjë do t'ju duket gri dhe e shuar dhe nuk keni energjinë e duhur për t'i përballuar situatat.



**LUANI** Sinqeriteti është gjithmonë një armë e mirë për t'u mbrojtur, edhe atëherë kur mendoni që nuk vlen për asgjë.



**VIRGJËRESHA** Dëshira e madhe që keni për ta ndryshuar rrënjësisht jetën tuaj do të duhet të presë për pak kohë. Nuk keni mundësi të bëni asnjë hap për momentin.



**PESHORJA** Sot do të ndiheni mjaft krenar me veten për shkak të një vendimi që keni marrë që ka përmirësuar jo vetëm jetën tuaj, por dhe atë të të tjerëve.



**AKREPI** Besimi dhe respekti duhet të jenë pjesë e rëndësishme e një marrëdhënieje sentimentale dhe nga kjo gjë nuk duhet të bëjë përjashtim marrëdhënia juaj.



**SHIGJETARI** Një lajm i rëndësishëm do t'ju bëjë ta ndryshoni drejtimin që keni marrë për një projekt të caktuar. Duhet ta kapni momentin.



**BRICJAPI** Jeni pak në ankth se si do të dalë një event që keni organizuar, por mjaft të keni durim dhe çdo gjë do të shkojë mirë.



**UJORI** Shumë kontakte të reja dhe takime mjaft të favorshme për ju sot. Këtë periudhë do të keni ndryshime të rëndësishme kudo.



**PESHQIT** Rutina e përditshme do t'ju largojë nga e brendshmja juaj dhe nga ato që mendoni. Sapo të keni pak kohë të lirë do të riktheheni aty ku ishit.

# Jenna Dewan është e lumtur me lidhjen e saj të dashurisë



Aktorja hollivudiane Jenna Dewan e ka bërë me dije në tetor të vitit të kaluar lidhjen e saj me Steve Kazee. Një burim për "the People" ka thënë se ajo është shumë e lumtur me lidhjen e saj, pasi thotë se Kazee sillet shumë mirë me fëmijën e saj. "Ajo është shumë e lumtur me këtë lidhje të dashurisë. Jenna mendon se Steve sillet shumë mirë me të bijën e saj", ka thënë ky burim për "People".



## Kim Kardashiani shkëlqen sërish

Ylli televiziv Kim Kardashian është fotografuar nga paparacët teksa kthehej nga shpatet e Apenit. Kardashiani pati të veshur një pallto dhe pantallona në ngjyrë metali. Kjo veshje i rrinte shumë bukur Kimit që e bënte atë të shkëlqente.

# Jennifer Lopezi, me veshje 100 mijë dollarëshe bën Pazar



Jennifer Lopezi njihet për veshjet që kushtojnë shumë, por kjo nuk do të thotë se ajo nuk blen rroba që nuk janë të markave më të njohura. Ylli i muzikës pop është parë që ka dalë për pazar në dyqanin e markës H&M bashkë me vajzën e saj 11-vjeçare Emme në Nju Jork. Lopezi gjatë kësaj dalje kishte zgjedhur një veshje që kushtonte në total më shumë se 100 mijë dollarë.

# Pas ndarjes, Emma Roberts në lidhje me Garrett Hedlundin



Emma Roberts dhe Evan Peters janë ndarë. Çifti i ka dhënë fund fejesës dhe lidhjes së tyre pesëvjeçare të dashurisë. "Ata kishin mospajtime dhe debate të shumta, por po përpiqeshin t'i tejkalonin dhe ta vazhdonin lidhjen e tyre. Ndarja e tyre ka kohë që pritej", ka thënë një burim pranë çiftit. Ndarja e tyre e kohëpaskohshme ka bërë që në lidhjen e tyre të dashurisë të kenë edhe konfrontime të ashpra por, sipas këtij burimi, çifti nuk kanë raporte të këqija. Por, megjithatë, duket se aktorja Roberts ka ecur tutje në jetën e saj, ajo është në lidhje me yllin e "Triple Frontier", Garrett Hedlund. Sipas një burimi pranë saj, Roberts dhe Hedlind kanë filluar të kalojnë kohë së bashku në shumë ngjarje të ndryshme para se ta nisnin lidhjen e tyre të dashurisë.

# Nëse një popull është në agoni dhe në narkozë të thellë, duhet kërkuar se kush e qiti në anestezion të përgjithshëm

- Me rastin e 20-vjetorit të rënies heroike të dëshmorit dhe intelektualit, profesorit të Historisë, Selim Berisha



**Nga Berat LUZHA**

Kalojnë vite, kalojnë edhe shekuj, e kujtimi për dëshmorët mbetet prore i freskët në mendjet tona, në kujtesën tonë historike. Brezat që vijnë do t'i mbajnë në zemër dëshmorët, për t'i bërë ata flamuj në valim rrugëve e shesheve tona të lirisë.

Liria ndërtohet me jeta, me gjak, me dëshmorë, kurse dëshmorët janë nderi dhe krenaria jonë.

U bënë 20 vjet që ra në altarin e lirisë shoku ynë i shtrenjtë, Selim Berisha. Profesori i historisë, Selim Berisha, ua mësonte nxënësve ngjarjet e mëdha, luftërat dhe përpjekjet e popullit tonë për liri dhe bashkim kombëtar. Profesori u fliste nxënësve për personalitetet tona kombëtare, për heronjtë e dëshmorët, për trimat e trimëritë ndër shekuj, që nuk reshtën kurrë, për sakrificat e popullit tonë për liri. Ai ua mësonte fëmijëve historinë, për të hyrë edhe vetë në histori, u fliste për dëshmorët, për t'u bërë edhe vetë dëshmor.

Profesori ra dëshmor në agun e ditës dhe në agun e lirisë, në pragun e shtëpisë dhe në prag të Shqipërisë. Ra atëherë kur bisha e plagosur po përpëlitej nëpër Kosovë duke bërë krime. Po ato krime nuk mund t'i duronte mësuesi patriot, duke i dalë bishës përballë dhe në përballje kishte rënë. Dhe, rënia e tij nuk ishte fundi i tij, ishte vetëm fillimi i përjetësimit të emrit e të veprës së tij në histori. Rënia e tij ishte ora e fundit e historisë. Këtë herë profesori po e mbante orën e historisë, jo para nxënësve, këtë herë orën e mbante para kombit të tij.

Selim Berisha nuk ishte vetëm një profesor historie në shkollën e fshatit të tij. Ai, me shumë kujdes dhe vëmendje, e përcillte situatën politike e shoqërore në Kosovën e okupuar gjatë viteve




'90 të shekullit të kaluar. Pos të tjerash, shkruante edhe shkrime analitike. Pata rastin ta njihja në redaksinë e gazetës "Rilindja" kur e pruri një shkrim për botim. Shkrimi i tij mbante titullin "Popullit duhet t'i thuhet e vërteta". Nga ky shkrim i gjatë po lexoj vetëm tri fjali:

Ky popull u ngop me dajak të pushtuesit, u ngop edhe me fjalë pompoze demagogjike që dalin nga goja e disa intelektualëve dhe e disa penave të zhurmshme. Nëse një popull është në agoni dhe në narkozë të thellë, duhet kërkuar se kush e qiti në anestezion të përgjithshëm.

Popullit duhet t'i thuhet e vërteta, sado e hidhur të jetë ajo!

Si pjesëtar i Ushtrisë së lavdishme Çlirimtare dhe nga karakteri i tij i fortë, Selimi nuk mund t'u bindej hordhive pushtuese. Kur u ballafaqua me ato, ai zgjodhi luftën para nënshtrimit, zgjodhi lavdinë para poshtërimit. Historia e kishte mësuar se si luftohet e vdiset për liri. Sepse liria nuk ka çmim apo, më mirë, çmimi është vetë liria.

Lufta e profesorit ishte krejt e veçantë. E veçantë është në formë, në metodë, në kohë. Lufta e tij, megjithatë, ngjante shumë me luftën e Afrimit e të Fahriut, të Rexhepit e të Nuhiut, të Tahir Mehës, të Ahmet Delisë e të shumë trimave e heronjve kombëtarë.

Sot nxënësit e profesorit jetojnë e punojnë të lirë në atdheun e tyre. Tashmë ata janë burrëruar dhe punojnë e kontribuojnë për ndërtimin e shtetit të tyre. E shteti i tyre u bë edhe në saje të luftës dhe flijimit të profesorit të tyre, Selim Berishës.

Fëmijët e tij dhe tërë familja, fshati dhe tërë Kosova përballë dhembjes kanë krenarinë. Se, t'i japësh atdheut më të dashurin e familjes është një nder e krenari, është edhe detyrë. Dhe, këtë detyrë jo gjithkush e kryen.

Dëshmorët janë vetë liria jonë!

Lavdi dëshmorit Selim Berisha!

Lavdi dëshmorëve të kombit!

# Këto ditë në Shkup u përurua libri 'Fitorja diplomatike' i Sabri Kiçmarit





SHKUP, 22 MARS (ER) - Në kuadër të aktiviteteve promovuese të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, këtë javë u promovua libri "Fitorja diplomatike" i autorit prof. dr. Sabri Kiçmari, diplomat karriere nga Republika e Kosovës. Të pranishëm në këtë ngjarje ishin kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ministri i Arsimit dhe Shkencës, prof. dr. Arbër Ademi, deputetë, drejtorë institucionesh, profesorë dhe studentë. Në fjalën hyrëse të ceremonisë së promovimit, nikoqiri, rektori i UNT-së, prof. dr. Aziz Pollozhani, u ka uruar mirëseardhje mysafirëve të shumtë nga vendi dhe Kosova, ndërsa veprën e profesor Kiçmarit e vlerësoi pasuri të madhe për historianët, që i jep dritë periudhës së bisedimeve diplomatike të përfaqësuesit të atëhershëm politik të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Kiçmarit me diplomatë evropianë.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi, ka thënë se veprat si kjo e profesor Kiçmarit janë kontribut i çmuar për studentët dhe gjeneratat e reja, të cilat kanë mundësi të njihen për së afërmi me veprimtarinë e diplomatëve shqiptarë, si dhe me aftësitë e të komunikuarit dhe zgjidhjes së problemeve përmes dialogut.

Recensuesi i librit, Agron Buxhaku, ka thënë se gjatë veprimtarisë së 30 vjetëve më parë, as që ka mundur të paramendohet se në qendër të Shkupit, në një universitet publik në gjuhën shqipe, siç është UNT-ja, do të mund të promovohet një libër dedikuar Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Libri "Fitorja diplomatike", i prof. dr. Sabri Kiçmarit, është përmbledhje kujtimesh nga përfaqësimi diplomatik i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe dëshmon për kontaktet e para të UÇK-së me kancelaritë evropiane.

Prof. dr. Sabri Kiçmari është nga Podujeva, ndërsa ka diplomuar në Fakultetin e Shkencave Politike në Bon të Gjermanisë, ka magjistruar në filozofi politike në vitin 2001, ndërsa në qershor të vitit 2007 ka doktoruar në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Bonit. Ka qenë ambasador i Kosovës në Austri dhe Australi, ndërsa tani është ligjërues në Universitetin e Prishtinës.

# Kush është Jacinda Ardern, që nga DJ u bë Kryeministre

Ajo është liderja më e re femër në botë, duke përfshirë Zelandën e Re si Kryeministre në moshën 37 vjeçare. Por përpara se të merrte detyrën e rëndësishme, Jacinda Ardern bënte një jetë tjetër…..në skenë – një kontrast i madh me detyrat e saja politike. Të dhënat tregojnë se Jacinda dikur ishte DJ. Pas buzëqeshjes së saj të ëmbël, politikania luajti muzikë si DJ për 45 minuta në festivalin e muzikës Laneway të Auckland në 2014.

Që kur u bë udhëheqëse e Partisë Laburiste, Instagrami ilustron karrierën e saj, e cila shfaqet si një grua luftëtare. Spinoff zbuloi gjurmët e DJ-ve amatorë, nga e kaluara e saj. Fillimisht ajo luante muzikën e Spice Girls, Beatles, Iggy Pop dhe Snoop Dogg.

"Ajo është ende e njëjta grua e vërtetë, e sjellshme dhe tepër e mençur. Është një mike që mund të të shkaktojë të qeshura", tha Isabelle Truman, e cila e ka njohur që në vitin 2014.

Gjatë një interviste Truman bëri një pasqyrim të shkurtër rreth jetës së Kryeministres së Zelandës së Re, duke thënë se ajo ishte liderja më e re femër në botë.

Znj. Ardern u lind në një familje të besimit mormon dhe ishte shumë e devotshme. Rreth të 20-ve e la besimin në mes dhe pranoi martesat e të njëjtit seks. Duket se ajo gjithmonë ka pasur interes për politikën. Zonja Ardern bënte fushata në zgjedhjet e shkollës së mesme – duke i bërë thirrje shkollës që të lejonte vajzat të vishnin pantallona.







Në moshën 17-vjeçare, filloi vullnetarizmin për Partinë Laburiste – duke shpërndarë fletushka. Ajo ndërroi gardërobën e saj, nga veshjet e thjeshta tek kostumet dhe në vitin 2008 u bë deputetja më e re e Zelandës së Re.

"Unë e pranoj që nuk jam një person normal", tha në fjalimin e saj të parë në Kuvend, Ardern. Atë kohë, ajo u takua me prezantuesin e tanishëm televiziv, Clarke Gayford. Ky i fundit i kishte shkuar një letër ku i shfaqte shqetësimet rreth një projekt-ligji që kishte të bënte me sigurinë. Ajo që filloi si miqësi, u shndërrua shumë shpejt në një romancë dashurie. Në fillim të këtij viti zonja Ardern dha lajmin se po pret një fëmijë, duke e bërë atë udhëheqësen e parë në botë që nga viti 1990, që pret një fëmijë ndërsa ishte në detyrë. Ajo pret fëmijën e parë me partnerin e saj Z. Gayford.

"Unë do të jem një Kryeministre dhe një mama. Ndërkohë Clarke do të jetë shtëpiak, për tu kujdesur për fëmijën", tha ajo në njoftimin e saj.

Në një deklaratë zyrtare, znj. Ardern konfirmoi se do të nisë punën 6 javë pasi të lindë fëmijën, që pritet të vijë në jetë me 17 qershor. "Do të bëj një marrëveshje me ministrat e mi, në kohën që nuk do të jem në punë. Nuk jam gruaja e parë në botë që punoj dhe kam një bebe. E di që këto janë rrethana të veçanta, por kemi edhe gra të tjera që e kanë bërë këtë gjë më parë", tha shefja e qeverisë.

**Përgatiti: Gazeta Shqip**

# Ja çfarë nuk duhet të veshin burrat pas moshës 50-vjeçare

## Nga xhinset me bel të lartë te pantallonat ushtarake

Adrian Clark në Guardian rendit hapat e gabuar të njerëzve përjetësisht të rinj: nga xhinset me bel të lartë të pëlqyera nga Obama te atletet 'Converse'. U thoni po trikove të gjata dhe golfeve.

### Burrat "rinor"

Mosha nuk është vetëm një numër dhe ky është supozimi nga i cili eksperti i stilit Adrian Clark sqaron në Guardian, ndërsa ai i rendit të gjitha hapat e rreme që një pesëdhjetë vjeçar mund të marrë në kërkim të stilit të tij. "Ekziston një presion i pafund për të vazhduar me tendencat", shton komentuesi, duke vënë në dyshim të gjithë burrat "rinor": shumë burra mbi moshën 50 vjeç janë të ndarë ose midis atyre që janë dorëzuar ose atyre që ata nuk e dinë kur është më mirë të ndalen". Kështu lindi një udhëzues i arsyetuar për të mos qenë shumë i dendur (ndoshta i veshur me një xhinse me bel të lartë të pëlqyera nga Obama) ose jashtë kontekstit, të guximshëm me një kapele base-





ball të stilit të Forrest Gump (kuruar nga Michela Proietti).

### Pantallona ushtarake

Ndër gjërat e para për të hequr nga veshjet, nëse keni mbushur 50 vjeç, janë pantallonat ushatarake. "Çdo pantallonë e tepërt, me shumë xhepa ose zips, ose një dekoratë tërheqëse që kujton botën ushtarake, duhet të dalë me mirësjellje nga veshjet", shpjegon Clark. Alternativa? Pantallona me një prerje të rastësishme-formale apo pantallona të gjera, por me më shumë paraqitjet se pizhamet. Ngjyrat e preferuara? Kafe ose bezhë.

### Atletet 'Conserve'

"Converse", sidomos në model, Jack Purcell, që unë zotëroja në të gjitha ngjyrat e mundshme, duhet të ndalohet", shpjegon guru i stilit. Efekti që mund të keni është ai i një trajneri të moshës së mesme, ose më keq, dikush që përpiqet me dëshpërim për të qëndruar të rinj. Arritja e 50 viteve nuk do të thotë që ju nuk do të jeni në gjendje të vishni atlete: një Adidas Stan Smith mund ta zbusë edhe ashpërsinë e një kostumi pune, për aq kohë sa është në harmoni me kostumin e përshtatur. Këshilla për atlete? Pas moshës 50-vjeçare investoni në artikujt që kushtojnë pak më shumë, por do të zgjasin shumë kohë. Një gabim tjetër i bërë nga burrat është të mbash gjërat për dekada, në besimin se do të kthehen në modë: ringjalljet janë të destinuara për një brez të ri.

### Ashtu si Forrest Gump

A janë kapelet e Forrest Gump-it pasioni juaj? Arsyetoni pak, ata janë në listën e zezë së bashku me xhinset e ngushta, parkas dhe këmisha hawaiiane.

### Qafa e lartë (si Burton)

Së bashku me gjërat që nuk duhet të vishen, Clark gjithashtu liston ato të etiketuara si golfe me qafë të lartë. "Ngushëllimi është i rëndësishëm, por nuk duhet të japim përshtypjen se kemi hequr dorë plotësisht nga moda".

### Xhinset me bel të lartë

Një tjetër qëndrim i papërshtatshëm që i jepet moshës: duhet të shmanget çdo gjë në një vend të e-commerce që paraprihet nga fjala si "xhinse me bel të lartë", (të dashura nga Obama) tërësisht. "Fjala është përdorur me ironi për të përshkruar diçka që babai juaj duhet të shmangë. Këto lloj xhinsesh janë shumë të përshtatshme për djalin tuaj, por jo për ju.

### Triko me kopsa

Triko me kopsa pas moshës 50-vjeçare? Xhaketa të lehta të bëra me pëlhura të butë dhe më rastë-





sore. "Lacoste bën një xhaketë të madhe që duket sikur mban një triko", shpjegon Clark. Bartësi standard i këtij stili është David Beckham, edhe pse marrja e balancës midis rastit dhe formës mund të jetë e ndërlikuar.





EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com
Montimi Servisim Porosi



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045 82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| GJEORGJIA - ZVICRA | 2-2 | SPANJA - NORVEGJIA | DP1 | ITALIA - FINLANDA | 1 |
|---|---|---|---|---|---|

# Sermaxhaj: Suksesi në Ligën e Kombeve, jo i rastësishëm

Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka arritur një tjetër rezultat fantastik, duke e çuar në njëmbëdhjetë numrin e ndeshjeve pa humbje. Analisti Genc Sermaxhaj për "Epokën e re" ka thënë se u dëshmua të enjten se rezultatet në Ligën e Kombeve nuk ishin të rastësishme. "Kosova po vazhdon formën më të mirë edhe me kombëtare të mëdha siç është Danimarka, sepse kundërshtarët në Ligën e Kombeve ishin më të dobët. Kjo përballje ishte e mirëseardhur për të vazhduar me formën e mirë, por edhe për t'iu treguar të gjithëve se rezultatet në Ligën e Kombeve nuk kanë qenë të rastësishme. Lojtarët në ndeshjen ndaj Danimarkës ishin në nivel të detyrës me paraqitjen dinjitoze. Edhe një herë treguan karakter dhe dëshirë të madhe për t'i mbrojtur ngjyrat e Kosovës", ka thënë Sermaxhaj

EPOKA E RE Veton ZYMBERI




PRISHTINË, 22 MARS - Analisti i futbollit në Kosovë, Genc Sermaxhaj, për "Epokën e re" i ka bërë një analizë të hollësishme ndeshjes miqësore që Kosova e zhvilloi ndaj Danimarkës të enjten në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Sipas tij, kjo paraqitje që përfundoi baras (2-2), dëshmoi edhe një herë se rezultatet në Ligën e Kombeve nuk ishin të rastësishme. "Kosova po vazhdon formën e saj të mirë edhe me kombëtare të mëdha si është Danimarka, sepse kundërshtarët në Ligën e Kombeve ishin më të dobët. Kjo përballje ishte e mirëseardhur për ta vazhduar formën e mirë, por edhe për t'iu treguar të gjithëve se rezultatet në Ligën e Kombeve nuk kanë qenë të rastësishme. Lojtarët pa dallim në ndeshjen ndaj Danimarkës ishin në nivel të detyrës me paraqitjen dinjitoze. Edhe një herë treguan karakter dhe dëshirë të madhe për t'i mbrojtur ngjyrat e Kosovës", ka thënë Sermaxhaj.

Ish-futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës e ka lavdëruar punën që po bën trajneri Bernard Challandes, kurse në lidhje me ndeshjen e radhës ndaj Bullgarisë, ka thënë se duhet koncentrim, për faktin se nuk është miqësore. "Dora e gjithë këtyre ndryshimeve është trajneri Chalandes, i cili ka sjellë një mentalitet dhe mënyrë tjetër të lojës nga ajo e kaluara. Lojtarët nuk iu frikësuan mbrëmë danezëve dhe ishte Kosova që ishte me kërkuese, sidomos me depërtimet nga krahët. Lojtarët që u zëvendësuan mendoj se duhet të jenë më të koncentruar dhe të japin më shumë nga vetja. E rëndësishme ka qenë paraqitja, jo rezultati, prandaj ndeshja e radhës ka rëndësinë e vet, nuk është kontrolluese dhe mendoj se do të jetë më e vështirë se ndaj Danimarkës, sepse ndikon faktori psikik në këtë takim, kur e dimë se fitorja është në plan të parë", ka shtuar Sermaxhaj.

I pyetur se cilat janë shanset e Kosovës për t'i mposhtur bullgarët, Sermaxhaj ka deklaruar: "Besoj se me një paraqitje të tillë sikur ndaj danezëve, do ta mposhtim Bullgarinë të cilën në asnjë mënyrë s'duhet ta nënçmojmë".

Për rezultatin e barabartë të arritur ndaj Danimarkës foli edhe mesfushori me përvojë të madhe në futbollin e Kosovës, Dugagjin Gashi. Anëtari aktual i Dukagjinit të Klinës ka qenë për një kohë të gjatë pjesë e përfaqësueses para pranimit në UEFA dhe FIFA. Ai ka thënë se të enjten në mbrëmje "Dardanët" i treguan botës se Kosova ka një përfaqësuese serioze. "Loja e Kosovës ka qenë fantastike dhe i kemi treguar gjithë botës se kemi një përfaqësuese shumë të fortë. Shumica e lojtarëve janë të rinj dhe kjo tregon se kemi një të ardhme të sigurt, kurse jam i bindur se në ndeshjen ndaj Bullgarisë do të korrim fitore. Personalisht e përgëzoj trajnerin për punën që po bën dhe lojtarët për shpirtin luftarak që po tregojnë në secilën ndeshje", ka deklaruar Gashi.

Kosova ka një seri pozitive, ku në njëmbëdhjetë ndeshjet e fundit nuk ka pësuar humbje, por test serioz do të ketë të hënën në stadiumin "Fadil Vokrri" ndaj Bullgarisë. Lidhur me këtë ndeshje, trajneri Gani Sejdiu ka thënë për gazetë se do të përpiqet vetëm për fitore. "Kosova s'bën të kërkojë barazim, sidomos kur luan vendëse. Nuk besoj se barazimi është i mjaftueshëm, prandaj lojtarët duhet të luajnë me kujdes të madh. Pas suksesit në Ligën e Kombeve, jemi në një fazë tjetër dhe kemi potencial për të kërkuar më shumë. Tjetër gjë është kur luajmë ndaj Anglisë, por ndaj Bullgarisë duhet ta kërkojmë maksimumin, edhe pse është një kombëtare me traditë, por që tash është në fazën e tranzicionit", ka thënë Sejdiu.

SHKURT

## Ndeshje revyale në basketboll për nder të familjes Berisha dhe Isuf Lumit

Nën organizim të KB Golden Eagle Ylli dhe në mbështetje të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) në Suharekë do të organizohet një ndeshje revyale për nder të dëshmorëve të rënë të familjes Berisha si dhe për nder të të ndjerit Isuf Lumi, ish-sekretar i Përgjithshëm i FBK-së. I ndjeri Isuf Lumi ka qenë kryetari i parë i FBK-së pas mëvetësimit të sportit të Kosovës, ndërsa pas luftës për disa vjet radhazi ka qenë në rolin e sekretarit të Përgjithshëm të FBK-së, duke kontribuar maksimalisht në të gjitha mënyrat për zhvillimin e basketbollit. Në këtë ndeshje revyale, e cila do të zhvillohet më 25 mars 2019 (e hënë), me fillim nga ora 18:00, në palestrën "13 Qershori" në Suharekë, do të takohen organizatori i këtij aktiviteti, KB Golden Eagle Ylli kundër lojtarëve të huaj që luajnë në Superligën e Kosovës.

## Berisha: Duam fitore ndaj Bullgarisë

Bernard Berisha është paraqitur në pjesën e dytë ndaj Danimarkës në miqësoren që përfundoi 2-2. Mesfushori ofensiv ka thënë se Kosova duhet të luajë për fitore në ndeshjen e parë të kualifikimeve për "Euro 2020" ndaj Bullgarisë. "Bëmë një ndeshje të mirë ndaj Danimarkës. Shpresoj të bëjmë mirë edhe ndaj Bullgarisë sërish. Ndeshja me Bullgarinë do të jetë ndryshe, por normalisht se do të futemi në fushë për të marrë fitore", ka deklaruar Berisha.

## Bale: CR7, lojtar i jashtëzakonshëm

Kur Gareth Bale e Cristiano Ronaldo luanin së bashku te Real Madridi, spekulohej shpesh mbi marrëdhënien e tyre, aq sa shkohej deri aty sa të thuhej se yjet e futbollit nuk shkonin aspak mirë për shkak të xhelozisë mes tyre dhe garës për të qenë "gjeli" i ekipit. Tani uellsiani zbulon si ka qenë realisht marrëdhënia e tij me yllin aktual të Juventusit. Në një emision të BT Sport, "What I Wore", ku futbollisti flet për fanellat e karrierës së vet, Bale ka folur për Ronaldon: "Lojtar i jashtëzakonshëm. E kam shijuar në maksimum të luajturit me të. Natyrisht, ka pasur shumë gënjeshtra, media është munduar t'i trumbetojë gjithë ato probleme që nuk ekzistonin realisht. Kishim marrëdhënie shumë të mirë. Ronaldo është një lojtar i pabesueshëm, ka bërë gjëra të jashtëzakonshme për Realin, mjafton të shohësh sa gola ka shënuar".

